

**Ismet Potera Luljeta Shala
Bekim Morina Safete Shala**

**GJENDJA DHE ZHVILLIMET AKTUALE QË NDIKOJNË
NË CILËSINË E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË
KOSOVË**

(ARSIMI I OBLIGUESHËM, NIVELET I DHE II)

Prishtinë, 2019



Ismet Potera Luljeta Shala
Bekim Morina Safete Shala

**GJENDJA DHE ZHVILLIMET AKTUALE QË NDIKOJNË NË
CILËSINË E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË
(ARSIMIN E OBLIGUESHËM, NIVELET I DHE II)**

Prishtinë, 2019

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Nezir Çoçaj

Ismet Potera

Luljeta Shala

Bekim Morina

Safete Shala

Miratar nga Këshilli Shkencor**Lektor:**

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

Përmbajtja

Parathënie	5
HYRJE.....	9
Konteksti i problemit - Kosova	9
METODOLOGJIA	13
Qëllimi.....	13
Popullata dhe mostra	13
Instrumentet dhe metodat	15
Procedura e mbledhjes së të dhënave	15
Procedura e analizës së të dhënave.....	15
REZULTATET.....	16
Gjendja në arsimin e Kosovës	16
Karakteristikat e mësimdhënësve	17
Zhvillimi profesional i mësimdhënësve - trajnimet e ndjekura	20
Mësimdhënësit 6-9, në nivel vendi.....	23
Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit lëndorë, niveli 6-9.....	25
Vijimi i mësimëve nga nxënësit	27
TREGUESIT SIPAS KOMUNAVE	34
Komuna e Deçanit	34
Komuna e Drenasit	41
Komuna e Gjakovës	54
Komuna e Ferizajt	59
Komuna e Malishevës	62
Komuna e Fushë-Kosovës	66
Komuna e Gjilanit	71
Komuna e Kaçanikut	77
Komuna e Kamenicës.....	82

Komuna e Klinës	87
Komuna e Lipjanit	92
Komuna e Mitrovicës	96
Komuna e Pejës	100
Komuna e Podujevës	104
Komuna e Prishtinës	108
Komuna e Prizrenit	112
Komuna e Shtimes	116
Komuna e Skenderajt	120
Komuna e Suharekës	123
Komuna e Vitisë	127
Komuna e Vushtrisë	131
PËRFUNDIME	135
REKOMANDIME	139
Post scriptum	142
REFERENCAT	143

Parathënie

Treguesit e arsimit janë udhërrëfyesit më të mirë për përmirësimin e politikave dhe praktikave në proceset që zhvillohen në shkollë. Studimi që po u prezantohet lexuesve dhe vendimmarrësve, në veçanti, është i bazuar në grumbullimin dhe analizën e disa treguesve, nëpërmjet të cilëve janë sheshuar disa aspekte të rëndësishme të gjendjes në arsimin e detyrueshëm në Kosovë.

Gjatë grumbullimit të këtyre treguesve, hasëm në disa çështje të rëndësishme, të cilat duhet të përmirësohen në të ardhmen. E para, jo të gjitha Drejtoritë Komunale të Arsimit mbajnë shënime me të dhëna të rëndësishme për shkollat e komunës, të cilat duhet të përdoren për diagnostikimin e gjendjes dhe marrjen e vendimeve. Shumica e komunave nuk kishin të dhëna për treguesit e trajtuar në këtë studim, siç janë: mungesat e nxënësve, suksesi i nxënësve i analizuar sipas specifikave, përvoja e mësimit të mësimit, trajnimet e mësimit të mësimit e të ngjashme.

E dyta, jo të gjitha shkollat i përditësojnë të dhënat e kërkuara. Edhe ato shkolla që i kanë, në formë numrash, nuk kanë bërë ndonjë analizë të tyre për të parë kahun e zhvillimit të procesit ose të dukurisë në shkollën e tyre, si p.sh. numri rekord i mungesave, sidomos në klasën IX. Nëse kërkon arsyetim prej tyre, drejtorëve ose mësimit të mësimit, kanë plot arsyetime, por nuk kanë bërë ndonjë analizë për të verifikuar shkaqet e prezencës së një dukurie të kështillë në shkollë.

Si pasojë e mungesës së analizës së treguesve, në shumë shkolla ndodhin të "papritura", kur një mësimit të mësimit pensionohet dhe nuk është planifikuar zëvendësimi i tij, kur mësimit të mësimit u duhen kredi për përtëritje të licencës dhe nuk dihet se sa trajnime i kanë ndjekur gjatë asaj periudhe, ose cilat janë nevojat e mësimit të mësimit për zhvillim profesional. E gjithë kjo ndodh si pasojë e mungesës së analizës së të dhënave.

Boshllëqet e identifikuar me këtë studim paraqesin një element të mirë për të bërë përmirësime dhe plotësime të tyre. E para, sa i përket lëvizjes së numrit të nxënësve brenda sistemit është konstatuar se nuk ka të dhëna të qarta lidhur me këto lëvizje. Një gjë është konstatuar, të cilën e kanë të

njohur të gjitha shkollat, se ka rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve në shkollim. Në shumicën e komunave të Republikës vërehet dallimi i numrit të nxënësve ndërmjet hyrjes në sistem dhe daljes nga sistemi. Bëjnë përjashtim komuna e Fushë- Kosovës dhe komuna e Prishtinës, në të cilat shihet një rritje në hyrje.

Numri i madh i mungesave në mësim është evident në të gjitha shkollat. Dallimi ndërmjet nivelit më të ulët, nivelit fillor, dhe shkollimit të mesëm të ulët është tejet i lartë. Pothuajse në të gjitha komunat veçohen nxënësit e klasës IX, me numër rekord të mungesave në mësim. Duhet theksuar këtu edhe një gjë të rëndësishme: në numrin e mungesave përfshihen vetëm ato gjatë ditëve të mësimin, por jo edhe të tjerat, kur për shkaqe të ndryshme procesi mësimor nuk është zhvilluar fare, si p.sh. gjatë grevës, për shkak të motit, ose për ndonjë arsye tjetër.

Gjithashtu, ky studim ka nxjerrë në pah të dhëna me interes sa i përket përvojës së mësimdhënësve, ku shihet se ka një mesatare të kënaqshme të moshës produktive të tyre. Edhe sa i përket numrit të trajnimeve të ndjekura, të dhënat tregojnë se shumica e mësimdhënësve kanë mbi 5 trajnime deri në kohën kur janë mbledhur të dhënat.

Përmbledhja e të dhënave dhe dhënia e rekomandimeve në fund të studimit paraqesin një udhërrëfyes të mirë për vendimmarrësit, për përmirësimin e praktikave dhe politikave arsimore të trajtuara në këtë studim. Analiza e të dhënave sipas komunave është element i rëndësishëm për shqyrtimin e gjendjes në nivel komune dhe shkolle. Prandaj, le të shërbejë si një dokument orientues për përmirësimin e treguesve të studiuar dhe të prezantuar në këtë monografi.

Preface

Education indicators are good guidelines for improving policies and practices in the processes that take place at school. The study being presented to readers and decision makers, in particular, is based on the collection and analysis of several indicators, through whom are reflected out some important aspects of the situation in compulsory education in Kosovo.

During the collection of these indicators we encountered on several important issues that need to be improved in the future. First, not all Municipal Education Departments hold important notes for municipal schools, which data should be used to diagnose the situation and making decisions based on that data. Most municipalities had no data on indicators addressed in this study, such as student absenteeism, student success is analyzed according to specifications, teacher experience, teacher training and the like.

Second, not all schools update the required data. Even those schools that have, in the form of numbers, do not have any of their analysis to see the direction of the development process or phenomenon in their school, such as record number of absences, especially in Class IX. If you ask for justification of them, principals or teachers, they have lots of excuses, but they have not done any analysis to verify the causes of the presence of such a phenomenon in school.

Due to the lack of indicator analysis, many schools happen to be "unexpected", when a teacher retires and his replacement is not planned, when teachers need license renewal credits and it is unknown how much training they have attended during that time. Period or what are the needs of teachers for professional development. All this happens as a result of lack of data analysis.

The gaps identified with this study represent a good element for making improvements and completing them. First, in terms of the movement of the number of students within the system it is concluded that there are no clear data on these movements. One thing that has been recognized by all schools is that there is a steady decline in the number of students in education. In

most municipalities of the Republic there is a discrepancy between the number of pupils entering the system and leaving the system. Exception municipality of Fushë Kosovo and Pristina municipality, in which there is an increase in the entrance.

The large number of absenteeism is evident in all schools. The difference between the lowest level, primary level and lower secondary education is very high. Almost all municipalities distinguished class IX students, a record number of absenteeism. It should be noted here one important thing: the number of absences include only those during school days, but not others, when for various reasons the learning process is not very developed, such as during the strike, due to weather or for any other reason.

Also, this study has highlighted interesting data regarding the experience of teachers, showing that there is a satisfactory average of their productive age. Even in terms of the number of trainings attended, the data show that most teachers have over 5 trainings by the time the data is collected.

Summarizing the data and making recommendations at the end of the study provide a good guide for decision makers to improve the educational practices and policies addressed in this study. Analysis of data by municipalities is an important element for examining the situation at the municipal and school level. Therefore, let us serve as a guiding document for the improvement of the indicators studied and presented in this monograph.

HYRJE

Arsimi parauniversitar në Kosovë akoma është në fazën e ndryshimit dhe të zhvillimit, prandaj edhe problemet dhe sfidat, me të cilat po përballen shkollat, janë të shumta. Çështja e rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të sistemit arsimor është preokupim i vazhdueshëm i shoqërisë. Për të rritur cilësinë në arsimin e obligueshëm, së pari duhet të analizohet gjendja në të cilën ndodhen shkollat. Të bëhet një hulumtim kabinetik dhe empirik, për të mësuar të arriturat e deritashme dhe sfidat, me të cilat përballlet arsimi parauniversitar. Vetëm duke e pasur një pasqyrë reale të gjendjes, me të dhëna të sakta, të analizuar në tërësi, mund të ndërmerren hapat për ngritje të cilësisë, andaj rezultatet e dala nga hulumtimi do të orientojnë në hapat që duhet ndërmarrë në të ardhmen. Prandaj, mendojmë se hulumtimi është me rëndësi për vetë shkollat, për Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe MASHT-in, për shumë arsye. Projekti qëndron në relacion me projektet prioritare të Ministrisë së Arsimit të Kosovës, për faktin se në Planin Strategjik kërkohet ndërtimi i kapaciteteve për ngritjen e arsimit cilësor në të ardhmen.

Të dhënat e marra nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shkollat duhet të analizohen me shumë kujdes, për të mësuar fushat në të cilat ka ngecur zhvillimi i cilësisë, cilat kanë qenë shkaqet, faktorët që kanë ndikuar, dhe të nxirren përfundimet dhe rekomandimet për institucionet përgjegjëse, të cilat çojnë në ngritjen e cilësisë në këtë nivel të arsimit. Me qëllim të vlerësimit të çështjeve prioritare, ekipi i hulumtueseve do të konsultohet vazhdimisht me popullatën e këtij hulumtimi dhe mbi bazën e vlerësimeve të para do të qartësojë qëllimin dhe objektivat e hulumtimit. Për hulumtimin e aspekteve të studimit, të lidhura me popullatën e hulumtimit, do të administrohen instrumentet e krijuara nga vetë hulumtuesit. Dizajni i hulumtimit do të përfshijë përmbledhjen e përgjithshme, qëllimin dhe objektivat e studimit, kontekstin e gjerë të studimit, metodologjinë e hulumtimit, rezultatet e hulumtimit, përfundimet dhe rekomandimet.

Konteksti i problemit - Kosova

Në Kosovë janë bërë disa analiza sa i përket gjendjes në arsim. Këto analiza, shpesh në formë të raporteve dhe të statistikave, nuk janë të mjaftueshme

për t'i identifikuar faktorët kryesorë, të cilët ndikojnë në cilësi, e pengojnë ose e ndihmojnë atë.

Deri më tani, është investuar shumë në arsimin parauniversitar, në infrastrukturë, në legjislacion, në hartimin e strategjive të ndryshme, në hartimin e kurrikulare dhe plan-programeve, teksteve shkollore, në trajnimin e mësimitdhënësve, stafin menaxhues dhe administrativ të shkollës, janë bërë hulumtime të ndryshme profesionale dhe metodologjike, janë botuar një sërë raportesh dhe dokumentesh të tjera për sfidat e arriturat në arsim, prandaj është e domosdoshme të mësojmë se cila është në të vërtetë sot gjendja në arsimin parauniversitar, a janë arritur objektivat e parapara me strategji dhe dallimet ndërmjet komunave.

MASHT - SMIA çdo vit nxjerr raporte për shkollat lidhur me numrin e mësimitdhënësve, nxënësve, drejtorëve dhe stafit tjetër të shkollës, sipas komunave, por raportet nuk analizohen në tërësi, përveç të dhënave për gjuhën, moshën, klasën, gjininë dhe përkatësisë kombëtare. Mungojnë të dhënat e sakta për trajnimin e mësimitdhënësve sipas fushave, përgatitjen, trajnimet e kryera. Po ashtu, edhe lëvizjet e nxënësve nga shkolla në shkollë, nga komuna në komunë, apo edhe jashtë vendit.

Për të bërë ndryshime në shkollë duhet bërë analiza dhe veprime të bazuara në të dhëna, sidomos kur kemi të bëjmë me cilësinë e edukimit. Prandaj, mjetet dhe veprimet për të bërë ndryshime duhet planifikuar, ndërsa aktivitetet duhet projektuar duke paraparë të gjithë hapat dhe strategjitë për të arritur ndryshimin.

Një element i një të dhëne nga një departament, i cili përcjell cilësinë e edukimit, mund të ndihmojë në vendimmarrje për përmirësimin e cilësisë së edukimit. Shtrohet pyetja, sa këto të dhëna evidentohen, regjistrohen, dokumentohen dhe analizohen në shkollë, apo në DKA? Praktika e deritashme në Kosovë tregon se këso të dhënash dhe analizash në nivel shkolle janë shumë të rralla. As në nivelin komunal nuk bëhet ndonjë analizë e të dhënave që vijnë nga shkollat, ose nga niveli qendror, SMIA ose ASK.

Problem më vete në këtë aspekt paraqet evidencimi i të dhënave cilësore, të cilat mund të përdoren për përmirësimin e cilësisë në edukim. P.sh., shkolla mban evidenca për trajnimin e mësimitdhënësve (numri i trajnimeve dhe

llojet), por nuk bën analiza lidhur me ndikimin e këtyre të dhënave në përmirësimin/ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve. Nuk bëhen analiza dhe krahasime midis të dhënave, të cilat kanë të bëjnë me cilësinë në arsim, me qëllim të konstatimit të trendit pozitiv ose negativ në një aspekt të caktuar të arsimit, si p.sh. Suksesit, mungesat, specifikat sipas lëndëve mësimore ose sipas shkollave e niveleve të arsimit. (Potera I., 2012).

Përgjegjës kryesorë për përmirësimin e performancës së mësimdhënësve janë shkollat, Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe Inspektorati, të cilat duhet të planifikojnë trajnime për mësimdhënës. Sipas Udhëzimit administrativ Zbatimi i Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve (2013), MASHT-i e ka përgjegjësinë të monitorojë zbatimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, të sigurojë standardet për sigurimin e cilësisë, monitorimin dhe vlerësimin, dhe të mbështesë zhvillimin profesional të mësimdhënësve duke adresuar prioritetet dhe nevojat e mësimdhënësve. Gjithashtu, udhëzimi përcakton edhe përgjegjësitë dhe rolin e DKA-ve dhe shkollave në këtë aspekt, por jo të gjitha shkollat planifikojnë trajnime dhe u krijojnë mundësi mësimdhënësve të ndjekin trajnime mbështetur në kërkesat dhe nevojat e dala nga monitorimi. Mësimdhënësit nuk mbështeten mjaftueshëm nga shkollat për të përmirësuar rezultatet e mësimdhënësve. Sipas drejtorëve të shkollave dhe kryetarëve të Këshillave Drejtues, rreth 70 për qind e prioritetëve në planet zhvillimore të shkollave ndërliken me përmirësimin e rezultateve në mësim, trajnimin e mësimdhënësve, për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. (Morina B., 2017).

Edhe pse DKA-të pranojnë nga shkollat dy herë në vit raporte që lidhen me mungesat e nxënësve, ne nuk gjetëm ndonjë dëshmi në formë të raportit të shkruar për analizën e bërë lidhur me shkaqet e mungesave, diskutimet dhe masat e ndërmarra për zvogëlimin e tyre përmes formave të ndryshme që mund të aplikohen, varësisht nga specifikat e shkollave. Megjithatë, në asnjë dokument të rregullave të sjelljes në shkollë, të miratuara nga DKA-të, nuk janë identifikuar kritere të cilat përcaktojnë mënyrat e arsytimit ose jo arsytimit të mungesave të nxënësve. Raportet statistikore tregojnë për numër të madh të mungesave të paarsyeshme, por edhe për numër të madh të mungesave të arsyeshme, të cilat, në mungesë të kritereve, mund të

supozohet se janë arsyetuar pa u mbështetur në kriteret bazë, meqë ato nuk ekzistojnë në formë të shkruar (Devetaku-Gojani H. & Mehmeti S., 2014).

DKA-të dhe shkollat nuk kanë ndërtuar mekanizma të ndërhyrjes dhe të llogaridhënies, për të informuar apo raportuar në mënyrë që të parandalohen mungesat e nxënësve dhe braktisja e shkollës. Shkaku i mungesave të paarsyeshme në mësim, nxënësit përballen me pasoja të shumta: ngecin mbrapa me mësim, suspendohen apo transferohen në ndonjë shkollë tjetër (Morina B.&Mekolli S., 2016)

Mungesat e shumta të nxënësve në orët e mësimin paraqesin rrezik permanent për ndërprerjen e mësimin nga ana e nxënësve. Ato janë shenja të braktisjes së mësimin nga një numër i nxënësve. Disa nga karakteristikat e fëmijëve që janë të prirë të braktisin shkollimin janë: ikjet nga orët e mësimin, mungesat e shumta, vonesat në mësimet dhe arsyetimet e pabazuara në fakte etj.

Dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit më së miri e njohin mësimdhënësit. Ata janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin mësimor, vazhdimisht e vëzhgojnë praninë e nxënësve dhe me të kuptuar se dikush nga nxënësit nuk ka vijueshmëri të rregullt në mësim, apo dikush nga nxënësit e ka lënë shkollën, informojnë drejtuesit e shkollave dhe bëjnë përpjekje që të punojnë bashkë me prindër /familje për të mbështetur kthimin e fëmijës në shkollë (Deva- Zuna A., 2009).

Është e rëndësishme që të dokumentohen problemet, sfidat dhe dështimet që dalin nga procesi i monitorimit, e pastaj të merren për bazë gjatë planifikimit, pasi pa monitorim të rregullt nuk pritet përmirësimi i rezultateve të mësimdhënësve dhe rritja e cilësisë. Kjo mund të bëhet vetëm nëse planifikohet mbi bazën e gjetjeve dhe rezultatet e monitorimit shërbejnë për të organizuar trajnime për mësimdhënësit. Pa ndonjë monitorim, proceset ndalen, njerëzit nuk dinë se çfarë të bëjnë, dokumentacionet nuk janë të plota dhe i tërë procesi i zhvillimit ndalet (GIZ, 2012).

Ende nuk ka koordinim të mirëfilltë të politikave shtetërore dhe lokale të arsimit, bashkëpunim të duhur ndërmjet Inspektoratit dhe shkollave gjatë planifikimit, edhe pse shkollat dhe komunat duhet të hartojnë planin zhvillimor në përputhje me legjislacionin në fuqi, me Strategjinë

Zhvillimore të Arsimit, dhe në ato plane të planifikojnë edhe monitorimin e mësimdhënësve dhe hapat që duhet ndërmarrë pas monitorimit, sipas nevojave dhe kërkesave që dalin gjatë monitorimit të mësimdhënësve në mësim. Qëllimi i planifikimit zhvillimor të shkollës është të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe të nxënies, përmes një procesi të rregullt dhe të pandërprerë të planifikimit, vlerësimit dhe rishikimit (KEC, 2010).

Në bazë të këtyre të dhënave, pastaj hartuesit e politikave arsimore do të kenë më lehtë të planifikojnë prioritetet për përmasimin e cilësisë në të ardhmen.

METODOLOGJIA

Hulumtimi është sasior, përshkrues dhe vlerësues. Të dhënat për realizimin e hulumtimit janë mbledhur nga burimet e publikuara (MASHT/ASK), si dhe drejtpërdrejt nga institucionet arsimore. Përpunimi i të dhënave është bërë sipas fushave të kërkuara, me pyetësorë.

Qëllimi

Identifikimi i karakteristikave të treguesve kryesorë, të përfshirë në sistemin arsimor të obligueshëm në Kosovë, me fokus në ndikimin e tyre në cilësinë e arsimit. Treguesit e mbledhur nuk mund të konsiderohen si ndikues të drejtpërdrejtë në cilësinë e suksesit dhe të performancës së shkollës, por janë me shumë rëndësi për sigurimin e cilësisë së performancës.

Popullata dhe mostra

Nga gjithsej 17464 mësimdhënës, që punojnë në arsimin përgatitor, fillor dhe të mesëm të ulët (MASHT/ASK 2018), në hulumtim janë përfshirë 109329, prej tyre 7999 ose rreth 73% mësimdhënës lëndorë (6-9). Ndërsa, nga gjithsej 6470 mësimdhënës përgatitorë (5-6) dhe të filllores (1-5) 5559, ose rreth 86% janë përfshirë në mostër. Të dhënat e përfshira në mostër janë dërguar nga vetë shkollat, me kërkesë. Vetëm komunat Skenderaj, Drenas, Suharekë dhe Malishevë të dhënat i kanë dërguar të përpunuara nga DKA-të.

Tabela 1

Numri i shkollave për komuna, të përfshira në analizë

Nr.	Komuna	Nr. Shkollave të përfshira
1	Deçani	16
2	Dragashi	10
3	Drenasi	29
4	F. Kosova	8
5	Ferizaj	12
6	Gjakova	39
7	Gjilani	9
8	H. I Elezit	3
9	Istogu	1
10	Kaçaniku	10
11	Kamenica	14
12	Klina	16
13	Lipjani	22
14	Malisheva	25
15	Mamusha	1
16	Mitrovica	21
17	N. Bërda	3
18	Peja	16
19	Podujeva	31
20	Prishtina	30
21	Prizreni	23
22	Rahoveci	21
23	Shtërpca	1
24	Shtime	8
25	Skenderaj	22
26	Theranda	28
27	Vitia	17
28	Vushtrria	30
Nr. i shkollave të përfshira		466
Gjithsej shkolla amë		634
Përqindja e përfshirjes		75%

Popullatën e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit e shkollimit të detyrueshëm në Kosovë (1-9). Mostra përbëhet nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të përfshira në hulumtim.

Instrumentet dhe metodat

Si instrument kemi përdorur protokollin me të dhënat e kërkuara. Instrumenti përbëhet nga tabela me të dhënat për nxënës, mësimdhënë, si dhe rubrikat për të dhënat. Të njëjtin instrument e kemi përdorur sipas shtresës së mostrës: për nxënës, mësimdhënë dhe për menaxherë të shkollave. Ndërsa metodat e përdorura ishin metoda e analizës së dokumentacionit, metoda statistikore dhe përshkruese.

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Mbledhja e të dhënave është bërë komunë për komunë. Disave u është dërguar versioni elektronik dhe të dhënat janë plotësuar nga shkollat ose nga DKA-të. Anëtarët e ekipit hulumtues me përgjegjësi kanë bërë mbledhjen e të dhënave specifike: për mësimdhënë, për nxënës ose menaxherë të shkollave, si dhe përpunimin e tyre në bazën e të dhënave për raportin.

Procedura e analizës së të dhënave

Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë bërë në programin Excel. Pastaj është bërë një filtrim i tyre për t'i verifikuar saktësinë dhe validitetin e të dhënave. Secili instrument është koduar sipas shtresës së mostrës dhe komunës. Të dhënat janë përpunuar nga ekipi hulumtues, duke përcjell saktësinë e tyre.

REZULTATET

Rezultatet e të dhënave të grumbulluara paraqiten sipas strukturës që po japim në vijim. Në rezultate përfshihen të dhënat në tabela, grafike, si dhe komentimi analitik i tyre. Gjithashtu, në kuadër të tyre do të përfshihet edhe krahasimi ndërmjet komunave, sa u përket çështjeve të trajtuara dhe rezultateve.

Gjendja në arsimin e Kosovës

Në bazë të të dhënave të fundit të MASHT/ASK (2018), Kosova ka gjithsej 23744 mësimdhënës në arsimin e detyrueshëm dhe në atë të mesëm të lartë. Struktura gjinore e mësimdhënësve në klasën përgatitore, në fillore dhe të mesme të ulët, është 43.8% (m) me 56.2% (f), ndërsa në arsimin e mesëm të lartë kjo strukturë gjinore e mësimdhënësve është 59.2% (m) me 40.8% (f) (MASHT/ASK, 2018).

Meqenëse objekt studimi është arsimi i detyrueshëm, në vazhdim prezantohen vetëm të dhënat për këtë nivel, gjegjësisht ato që ishin subjekt i punimit.

Sa i përket numrit të nxënësve aktualë në arsimin e detyrueshëm, sipas të dhënave të fundit (2019), në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët janë gjithsej 239937 nxënës (klasa 1-9), prej tyre djem 123580 dhe vajza 116357 (MASHT, 2019).

Po sipas të dhënave të MASHT-it, në vitin shkollor 2018/2019 janë gjithsej 942 shkolla. Nga ky numër, 634 janë shkolla amë dhe 308 shkolla vartëse.

Ministria e Arsimit, e Shkencë dhe e Teknologjisë ka një departament të veçantë, i cili merret me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për arsimin kosovar. Gjithashtu, të dhëna të ngjashme publikon edhe ASK-ja, të cilat pastaj në fund të vitit publikojnë një raport të përbashkët. Këto të dhëna paraqesin një burim të mirë për analiza të kaheve të zhvillimit të arsimit në Kosovë, por asnjëri nga këto burime të të dhënave statistike nuk merren me analizën e tyre. Ato prezantojnë numrin e nxënësve sipas niveleve, personelit në shkolla, por nuk prezantojnë edhe tregues relevantë dhe krahasues, nga të cilët do të mund të nxirrnin politika vendimmarrëse për përmirësimin apo avancimin e aspekteve të veçanta të ngecjes në arsim. Të

dhënat, të cilat janë të rëndësishme për orientimin e politikave kadrovike, siç janë ato për moshën dhe përvojën e mësimitdhënësve, kualifikimin e mësimitdhënësve dhe trajnimin sipas niveleve dhe lëndëve mësimore, të dhënat për arritjet e nxënësve sipas cikleve dhe lëndëve mësimore nuk prezantohen/raportohen. Prandaj, edhe nisma për një studim të tillë doli nga kjo nevojë e munguar, për të plotësuar këtë aspekt të prezantimit të gjendjes, me qëllim të njohjes me kahet e zhvillimit/lëvizjes të këtyre treguesve arsimorë.

Karakteristikat e mësimitdhënësve¹

Këtu prezantohen të dhënat e mësimitdhënësve të përfshirë në mostër, jo të gjithë mësimitdhënësit e Kosovës. Pasi që mostra përfshin numër të madh të mësimitdhënësve, të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, të dhënat paraqesin mjaft argumente për përgjithësimin e rezultateve. Prezantohen të dhëna, të cilat nuk raportohen nga MASHT-i dhe ASK-ja, siç janë: përvoja e mësimitdhënësve dhe numri i trajnimeve të ndjekura nga ana e tyre.

Për shkak të leximit më të lehtë të të dhënave, prezantimi është bërë sipas niveleve, fillor dhe i mesëm i ulët. Gjithashtu, të dhënat prezantohen në nivel vendi, si dhe sipas komunave.

Përgatitja profesionale e mësimitdhënësve: Sipas komunave, në nivel vendi.

¹ Të dhënat e interpretuara janë të viteve shkollore 2016/2017 dhe 2017/2018

Tabela 2

Mësimdhënësit sipas përvojës në arsim, në nivel vendi

Nr.	Komuna	Deri 1	Deri 5	6 - 10	11-15	16-20	25-30	30--35	36-40	Mbi 40vj.	Gjithsej
1	Deçani	2	25	18	15	7	11	14	4	2	98
2	Dragashi	5	9	2	5	1	9	2	1	2	36
3	Rahoveci	12	23	30	19	22	31	23	17	8	185
4	Gjakova	12	35	76	38	60	58	23	34	19	355
5	Ferizaj	10	32	87	28	39	85	38	125	1	445
6	H. I Elezit	3	1	6	5	6	8	2	8	2	41
7	Istogu	0	7	6	9	6	5	2	1	1	37
8	Mamusha	0	8	6	7	2	3	0	0	0	26
9	Malisheva	23	10	19	24	20	33	25	6	12	172
10	Drenasi	17	32	57	30	28	15	47	55	14	295
11	F. Kosova	10	8	23	18	16	19	8	13	12	127
12	Gjilani	9	21	35	24	29	30	16	12	1	177
13	Kaçaniku	13	18	13	24	15	23	12	12	5	135
14	Kamenica	5	11	17	26	22	25	21	17	0	144
15	Klina	16	13	21	18	34	42	7	5	7	163
16	Lipjani	12	18	33	53	43	41	25	34	21	280
17	Mitrovica	27	33	51	51	68	22	56	131	9	448
18	N. Bërda	2	11	5	2	5	2	0	0	1	28
19	Peja	12	22	25	36	25	19	17	10	15	181
20	Podujeva	32	46	54	49	46	38	15	19	12	311
21	Prishtina	23	57	114	66	54	56	32	30	16	448
22	Prizreni	14	31	63	35	39	62	34	30	13	321
23	Shtërpca	0	2	2	2	0	1	0	3	0	10
24	Shtime	18	20	20	22	8	9	10	10	26	143
25	Skenderaj	11	43	26	34	33	39	12	10	1	209
26	Vitia	13	17	45	34	32	22	20	15	4	202
27	Theranda	24	27	31	26	20	29	27	30	15	229
28	Vushtrria	24	38	58	43	37	22	13	26	12	273
	Gjithsej	349	618	943	743	717	759	501	658	231	5519
	%	6	11	17	13	13	14	9	12	5	100

Siç tregohet në tabelën 2, kategorizimi i përvojës është paraqitur në nëntë grupe të mësimdhënësve. Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve (5519 i deklaruar nga shkollat dhe DKA), në nivel vendi, më së shumti i përkasin grupit me përvojë 6 deri në 10 vjet përvojë në arsim (n=943 ose rreth 17%), pastaj grupin e dytë e përbëjnë mësimdhënësit me përvojë 25-30 (n=759 ose rreth 14%), si dhe në grupin e tretë bien dy grupe 11-5 dhe 16-20, me numër afërsisht të njëjtë (n=743, gjegjësisht 717 ose rreth 13%).

Grupmosha e nënvizuar në tabelë (n=3162) ose rreth 57% (përvoja 6-30) përbën grupin më produktiv, pasi që kanë dy elemente bazë: mosha dhe përvoja në mësimdhënie. Por, sipas të dhënave, përvoja më produktive do të duhej të ishte përvoja 5-15 vjet, e cila paraqet edhe moshën më vitale të mësimdhënësve. Ky grup i mësimdhënësve (n=2034, ose rreth 41% e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve) duhet të paraqiste pjesën më dinamike të mësimdhënies. Më së shumti mësimdhënës të këtij grupi përvojë ka Prishtina, me gjithsej (n=237 ose rreth 53%). Pasojnë Gjakova dhe Podujeva, me 48% të mësimdhënësve të Podujevës dhe rreth 42% e mësimdhënësve të Gjakovës. Kjo e dhënë është mjaft trimëruese për arsimin në këtë nivel.

Nga dy grupet e fundit (36-40 dhe mbi 40 vjet përvojë), me gjithë përvojën që kanë, nuk mund të pritët përkushtim maksimal, por edhe përballja me ndryshimet në teknologji, si dhe me nivelin e nxënësve të epokës digjitale. Në këtë grup janë 889 ose rreth 16% e mësimdhënësve të Kosovës. Në këtë grup moshë më së shumti ka në komunën e Shtimes, me mbi 40 vite (26), ndërsa në komunat tjera dallojnë në këtë grup, ekziston laramani. Numër më të madh të mësimdhënësve me përvojë deri një vit ka Podujeva, me (n=32 nga 311) ose rreth 10% e mësimdhënësve në nivel komune, e përcjell nga Mitrovica, me (n=27 nga 448) ose 6%.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve² - trajnimet e ndjekura

Njëri ndër faktorët për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës është cilësia e mësimitdhënies. Për përmirësimin/avancimin e cilësisë së mësimitdhënies është i domosdoshëm zhvillim profesional i mësimitdhënësve. Ministria e Arsimit ende nuk ka ndërtuar një platformë me të dhënat për nivelin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në përgjithësi në Kosovë. Dihet se në dekadat e fundit (2000-2018) mësimitdhënësit kanë ndjekur një varg programesh trajnimi. Për momentin, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin e mësimitdhënësve, vetëm trajnimet e akredituara iu llogariten si zhvillim profesional për licencim ose për përtëritjen e licencës (MASHT, UA, 2017), por jo edhe modalitetet apo format tjera të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në shërbim. Shumica e DKA-ve nuk i kanë të njëjtat të dhëna, prandaj edhe mbledhja e këtyre të dhënave ishte mjaft sfiduese. Shumica e drejtorëve të shkollës është dashur që këto të dhëna t'i mbledhin nga mësimitdhënësit, jo nga të dhënat e shkollës.

Në mesin e mësimitdhënësve, sa i përket numrit të trajnimeve deri në mbledhjen e të dhënave, shihet një larushi e numrit të trajnimeve të ndjekura nga ana e mësimitdhënësve.

Sa i përket llojit të trajnimeve të ndjekura, tani për tani është e pamundur të mblidhen të dhëna të tilla. Prandaj, të dhënat e prezantuara sa i përket numrit të trajnimeve janë të dhëna të deklaruara nga ana e shkollës.

² Sqarim: Në punim janë përdorur konceptet mësimitdhënës dhe mësues. Për kontekstin kosovar me mësues nënkuptohet mësimitdhënësi që punon në fillore, 1-5 (mësimitdhënës klasor). Kjo vlen sidomos për ta bërë dallimin në paraqitjen grafike të të dhënave.

Tabela 3


Mësimdhënësit sipas numrit të trajnimeve të ndjekura

Nr.	Komuna	1 deri 2	3 deri 5	Mbi 5	Asnjë
1	Deçani	16	26	41	1
2	Dragashi	2	11	12	0
3	Rahoveci	28	80	66	4
4	Gjakova	27	83	245	0
5	Ferizaj	80	130	205	9
6	H. i Elezit	4	18	25	0
7	Istogu	14	14	8	1
8	Mamusha	0	20	0	0
9	Malisheva	33	65	52	8
10	Drenasi	36	71	104	3
11	F. Kosova	13	27	69	7
12	Gjilani	14	26	132	0
13	Kaçaniku	17	40	74	1
14	Kamenica	60	75	0	0
15	Klina	18	36	68	5
16	Lipjani	50	88	128	11
17	Mitrovica	12	54	75	1
18	N. Bërda	0	15	12	0
19	Peja	19	40	107	5
20	Podujeva	94	117	59	14
21	Prishtina	16	99	318	7
22	Prizreni	51	91	174	8
23	Shtërpca	2	7	2	0
24	Shtime	31	57	48	1
25	Skenderaj	15	56	135	3
26	Vitia	48	91	55	4
27	Theranda	57	65	66	19
28	Vushtrria	61	78	122	15
	Gjithsej	818	1580	2402	127

Siç shihet në tabelën numër 3, numri më i madh i mësimdhënësve kanë ndjekur më shumë se 5 trajnime (n=2402) ose rreth 43% e tyre. Në vendin e dytë janë mësimdhënësit me 3 deri në 5 trajnime (n=1580) ose rreth 28% e mësimdhënësve të përfshirë. Vetëm rreth 2% e mësimdhënësve nuk kanë

ofruar të dhëna për trajnimet. Sipas kësaj, del se vetëm (n=127) e mësimdhënësve ose rreth 2% prej tyre nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Sa i përket nivelit komunal, në krahasim me numrin e mësimdhënësve dhe numrin e trajnimeve, me mbi 5 trajnime prin komuna e Gjilanit (n=177) ose rreth 75% prej tyre kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime. Pastaj mësimdhënësit e komunës së Prishtinës, që kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime (n=318) ose rreth 70%, e cila pasohet nga komuna e Gjakovës me (n=245) ose rreth 69% nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në nivel komune. Por, pa asnjë trajnim të deklaruar prin komuna e Therandës, pasi nga (n=229) rreth 8% prej tyre nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.



Grafiku 1

Numri i trajnimeve të mësimdhënësve dhe përqindja

Të dhënat e dala nga hulumtimi tregojnë se Drejtoritë Komunale të Arsimit, shkollat dhe institucionet e tjera përgjegjëse, nuk i kanë kushtuar mjaft rëndësi evidencave të sakta për trajnimin e mësimdhënësve. Jo të gjithë mësimdhënësit e nivelit fillor, të 28 komunave të Kosovës të përfshira në hulumtim, kanë kryer trajnime, që lë të kuptojmë se nuk është bërë ndonjë analizë paraprakisht, që trajnimet të organizohen në bazë të kërkesave dhe të nevojave të mësimdhënësve, duke i trajtuar si të barabartë dhe duke ua dhënë të gjithëve mundësinë për ngritje profesionale.

Mësimdhënësit 6-9, në nivel vendi

Për shkak të leximit dhe prezantimit më të qartë, të dhënat për personelin mësimor i prezantojmë të ndara. Sipas të dhënave statistike të MASH/ASK, në arsimin e mesëm të ulët janë gjithsej 7960 mësimdhënës.

Tabela 4


Mësimdhënësit 6-9, në nivel vendi

Nr.	Komuna	Deri 1 vit	Deri 5 vite	6-10	11-15	16-20	25-30	31--35	36-40	Mbi 40	Gjithsej
1	Deçani	4	13	15	14	35	38	13	9	2	143
2	Dragashi	3	8	12	8	11	8	7	8	1	66
3	Rahoveci	12	56	58	34	35	70	44	24	7	340
4	Gjakova	23	66	72	56	67	87	76	33	7	487
5	Ferizaj	5	27	28	20	18	16	17	6	2	139
6	H. i Elezit	2	9	13	10	3	7	1	2	0	47
7	Istogu	1	1	8	8	1	17	9	0	0	45
8	Mamusha	0	8	6	7	2	3	0	0	0	26
9	Malisheva	39	83	62	44	34	52	43	21	6	384
10	Drenasi	30	61	95	80	77	54	124	26	12	559
11	F. Kosova	12	31	23	15	39	34	13	2	0	169
12	Gjilani	12	26	54	29	45	52	32	12	3	265
13	Kaçaniku	5	23	26	22	35	44	27	9	2	193
14	Kamenica	13	27	30	42	22	31	19	6	0	190
15	Klina	30	33	26	30	46	55	42	20	0	282
16	Lipjani	26	65	65	44	38	46	73	42	8	407
17	Mitrovica	26	70	52	25	50	61	36	25	4	349
18	N.Bërda	5	9	6	0	1	3	1	0	0	25
19	Peja	11	41	49	45	47	52	38	15	1	299
20	Podujeva	20	95	79	56	65	137	67	40	6	565
21	Prishtina	18	78	226	65	126	155	65	21	11	765
22	Prizreni	14	62	73	6	96	105	64	41	7	468
23	Shtërpca	4	13	2	2	0	1	3	0	0	25
24	Shtime	8	39	47	20	19	21	24	24	7	209
25	Skenderaj	12	52	37	27	32	91	72	23	5	351
26	Vitia	13	57	54	26	48	45	38	17	1	299
27	Theranda	10	39	70	41	72	105	56	47	2	442
28	Vushtrria	25	76	79	45	64	75	32	15	10	421
	Gjithsej	383	1168	1367	821	1128	1465	1036	488	103	7960
	%	5	15	17	10	14	18	13	6	2	100

Siç shihet në tabelën 4, mësimdhënësit me përvojë 25 deri në 30 vjet dominojnë në krahasim me nivelet tjera të përvojës. Sipas kësaj nga

(N=7960), në këtë shkallë të përvojës bien (n=1465) ose rreth 18% e mësimdhënësve të përfshirë në mostër.

Sipas të dhënave, përvoja më produktive, mosha plus përvoja në mësimdhënie, është mes viteve 6 deri në 30 vjet përvojë. Në këtë kategori/grup të përvojës janë 4781 mësimdhënës ose rreth 60%, ndërsa në grupin e përvojës deri në 1 dhe deri në 5 vjet janë 1551 ose rreth 19%. Në grupin e tretë, përvoja 31 deri mbi 40 vjet, janë 1627 ose rreth 20%. Rreth 19% e mësimdhënësve 6-9 janë me përvojë 31-40 vjet, ose rreth moshës 60 vjeçe. Krahasuar me disa vende evropiane, afërsisht në nivel me Slloveninë (19.8%) dhe Poloninë (18.9%) (EU, 2010, f. 15). Afërsisht përqindje të njëjtë (19%) të mësimdhënësve 6-9 kemi edhe në moshën deri 30-vjeçare. Në krahasim me disa vende të Evropës, jemi më afër me Belgjikën (17.8%), Irlandën (17.5%) dhe UK (17.9%) (ibid. F. 15).



Grafiku 3

Shkalla e përvojës dhe përqindja, në nivel vendi

Shikuar sipas komunave, më shumti mësimdhënës të rinj, deri 1 vit përvojë, kishte komuna e Malishevës (n=39) ose rreth 10% nga (N=384). Pasohet nga komuna e Klinës dhe Drenasi me nga (n=30), Klina nga (N=282) ose rreth 10% dhe Drenasi (N=598) ose rreth 5%. Kjo e fundit gjithashtu ka më së shumti mësimdhënës me përvojë mbi 40 vjet, ku nga (N=559) janë (n=12) ose rreth 02%. Prishtina ka numrin më të madh (n=572) të mësimdhënësve të moshës produktive dhe të përvojës 6 deri 30 vjet, ose rreth 75%. Gjithashtu, kjo komunë mësimdhënës me përvojë 31 deri mbi 40 vjet ka (n=97) ose rreth 13%.

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit lëndorë, niveli 6-9

Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë (N=7960), numrin e trajnimeve të ndjekura e kanë deklaruar gjithsej (n=7202) ose rreth 90%. Këtu nuk janë përfshirë mësimdhënësit që nuk e kanë plotësuar asnjërën alternativë të kërkuar për numrin e trajnimeve të ndjekura deri në momentin e mbledhjes së të dhënave.


Rreth 75% e mësimdhënësve të përfshirë kanë ndjekur 3 deri në 5 dhe mbi pesë trajnime. 39% kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime dhe vetëm rreth 6% nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Tabela 5

Trajnimet e mësimdhënësve 6-9, sipas komunave të përfshira në mostër

Nr.	Komuna	1 deri 2	3 deri 5	Mbi 5	Asnjë	Gjithsej
1	Deçani	12	65	55	0	132
2	Dragashi	16	18	34	0	68
3	Drenasi	18	125	150	7	300
4	F. Kosova	25	56	74	17	172
5	Ferizaj	27	56	34	8	125
6	Gjakova	49	109	294	26	478
7	Gjilani	18	61	155	0	234
8	H. i Elezit	6	13	23	4	46
9	Istogu	12	20	10	3	45
10	Kaçaniku	52	58	84	2	196
11	Kamenica	59	116	3	9	187
12	Klina	57	91	77	18	243
13	Lipjani	94	141	118	30	383
14	Malisheva	79	132	98	45	354
15	Mamusha	3	14	5	0	22
16	Mitrovica	54	79	156	11	300
17	N. Bërda	10	16	5	0	31
18	Peja	52	93	126	17	288
19	Podujeva	165	228	67	25	485
20	Prishtina	58	210	338	4	610
21	Prizreni	61	173	254	40	528
22	Rahoveci	58	104	148	26	336
23	Shtërpca	12	10	3	0	25
24	Shtime	42	75	63	14	194
25	Skenderaj	32	68	210	10	320
26	Theranda	96	154	106	34	390
27	Vitia	127	113	37	15	292
28	Vushtrria	119	187	96	16	418
	Gjithsej	1413	2585	2823	381	7202
	%	20%	36%	39%	6%	100%
	Nuk kanë deklaruar numrin e trajnimeve të ndjekura					797

Numrin më të madh të mësimitdhënësve që nuk kishin ndjekur asnjë trajnim e kishte Malisheva, me (n=45) ose rreth 13% e numrit të deklaruar. Pastaj Prizreni me (n=40) ose rreth 8% dhe Theranda me (n=34) ose rreth 9%. Ndërsa, më shumë mësimitdhënës që kanë ndjekur 1 deri 2 trajnime kishte Podujeva, (n=165) ose rreth 34% nga numri i përgjithshëm që kanë deklaruar numrin e trajnimeve të ndjekura.



Grafiku 3

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimitdhënësit 6-9 në nivel vendi

Rreth 39% e mësimitdhënësve kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime. Gjatë mbledhjes së të dhënave kishte edhe të deklaruar me më shumë se 20 trajnime të ndryshme. Por kriteri i kërkesës ishte deklarimi i trajnimeve të ndjekura në 5 vitet e fundit, jo të gjitha. Me 3 deri në pesë trajnime prin Podujeva me (n=228) ose rreth 47%, e pasuar nga Prishtina me (n=210) ose rreth 34%. Ndërsa me mbi pesë trajnime të ndjekura prin Prishtina me (n=338), ose rreth 55% e mësimitdhënësve. Pastaj vjen Gjakova me (n=294) ose rreth 62% dhe Prizreni me (n=254) ose rreth 48%. Por, në krahasim me numrin e mësimitdhënësve, Skenderaj prin me numrin mësimitdhënësve që kanë ndjekur mbi pesë trajnime, ku (n=210) nga (N=320) ose rreth 66% e numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve të përfshirë.

Vijimi i mësimëve nga nxënësit

Një nga elementet e sigurimit të cilësisë së nxënies, edhe të rezultateve në nxënie, është vijimi i mësimëve nga ana e nxënësve. Mungesat në punë, në mësimitdhënie, është vështirë për t'i siguruar, pasi që shkollat nuk raportojnë të dhëna të tilla. Por, mungesat e nxënësve në mësimë evidentohen dhe


raportohen, sidomos në nivel shkolle, zakonisht kur bëhet raportimi i suksesit të nxënësve në fund të gjysmëvjetorit ose në fund të vitit shkollor. Statistikat për mungesat e nxënësve në mësimet paraqesin të dhënat e mungesave brenda një viti mësimor. Jo të gjitha shkollat i kanë ofruar këto të dhëna. Arsyeja nuk është deklaruar.

Tabela 6

Mungesat e nxënësve në mësimet brenda një viti, në nivel vendi

Komuna	Klasat									
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	(I-IX)
Drenasi	6120	5731	6352	6191	6878	12095	16155	15849	18268	93639
F. Kosova	3729	4784	3877	4658	4243	9346	10542	15058	17352	73589
Kaçaniku	2075	2670	2885	2301	2249	6277	6081	7327	7049	38914
Kamenica	1224	2018	2158	1701	1737	2434	3551	5941	8421	29185
Gjakova	5216	6925	7444	7967	12295	13160	17196	17022	24621	111846
Klina	3727	3905	3726	3937	3711	4989	8740	9629	9554	51918
Mitrovica	2103	2951	3222	4121	2813	5464	6669	7996	10638	45977
Malisheva	4992	4261	3504	4306	4008	7116	7607	8354	11379	55527
Ferizaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	00
Dragashi	543	649	961	1014	552	1329	1107	2257	2693	11105
Deçani	1664	1620	2358	2130	2514	3136	3820	4303	5944	27489
Gjilani	1029	1298	1233	1388	2700	2074	2783	5986	5369	23860
Prishtina	11036	13650	15899	15133	16910	34489	42646	54782	65388	269933
Peja	3020	3076	3593	5152	3773	8232	8770	10634	13085	59335
Podujeva	6369	7319	6365	7417	7456	16223	21112	19799	26463	118523
Skenderaj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	00
Vitja	3506	3809	3565	4767	4555	8962	15185	14743	25266	84358
Vushtrria	4002	4892	7225	8288	6605	13110	14021	18491	27610	104244
Hani i Elezit	348	550	485	588	657	2291	2603	2529	2559	12610
Istogu	273	1980	904	793	1215	3917	3797	3615	5203	21697
Prizreni	5432	5727	8230	8912	9510	16497	17981	24395	31525	128209
Suhareka	3418	4100	4133	3807	3591	6031	7490	7504	9205	49279
Lipjani	7236	7197	8598	9625	8833	18328	20441	22366	25157	127781
Shtime	4306	3197	3349	3875	4380	6642	6204	8670	10244	50867
Rahoveci	2589	2430	2864	3752	4775	8329	8139	13281	13543	59702
Shtërpca	171	379	150	90	99	288	222	132	379	1910
Mamusha	0	1	0	0	15	275	370	136	307	1104
N. Bërda	590	883	927	391	535	835	673	1354	2162	8350
Gjithsej	84718	96002	104007	112304	116609	211827	253085	290254	379384	1. 648 190

Në numrin e përgjithshëm të mungesave janë llogaritur të gjitha mungesat me ose pa arsye. Me rëndësi është fakti se nxënësit nuk kanë qenë prezent në orët mësimore. Shkaqet dhe arsyetimi nuk janë kërkuar me instrumentin për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat për ciklin fillor janë paraqitur në grafikun në vijim. Ka dallime të dukshme sa i përket raportit numër i nxënësve dhe mungesa në nivel komune. Prishtina, sipas ASK (2018), ka gjithsej 30087 nxënës (1-9) dhe 269933 mungesa, ose rreth 8.97 mungesa për kokë nxënësi. Ndërsa Deçani ka gjithsej 4196 nxënës dhe 27489 mungesa ose rreth 6.55 mungesa për kokë nxënësi. Vitia 6106 nxënës dhe 84358 ose rreth 13.81 mungesa për kokë nxënësi. Drenasi me 10,6 mungesa për kokë nxënësi etj. Të dhënat për komunat do të prezantohen në kuadër të raportit për komuna.




Grafiku 4

Mungesat e nxënësve sipas klasave

Nga numri i përgjithshëm i mungesave, prej 1 648 190 mungesa, 1 134 550 ose rreth 69% janë bërë nga nxënësit e shkollës së mesme të ulët dhe 513640 ose rreth 31% nga nxënësit e shkollës fillore.


Diferenca midis kufirit të poshtëm, klasa e parë, dhe kufirit të epërm, klasa e nëntë, është për 1563477 mungesa. Sipas ASK/MAShT (2018), në klasën IX ishin gjithsej 28658 nxënës, të cilët kanë bërë 379384 mungesa ose 13.23 mungesa për kokë nxënësi. Sipas kësaj, i bie që secili nxënësi i klasës IX të ketë humbur rreth dy ditë të plota mësimi në vit.



Grafiku 5

Mungesat e nxënësve sipas klasave, 1-5

Siç shihet, shpërndarja e mungesave nëpër klasë vjen duke u rritur nga klasa e parë deri në të pestën. Dallimi në mungesa sipas klasave është i dukshëm. Ndërmjet klasës së parë dhe të pestë vërehet dallim shumë i madh, 31891 ose rreth 16% e mungesave të nxënësve të shkollës fillore u takojnë nxënësve të klasës së parë.




Grafiku 6

Mungesat e nxënësve 1-5, shprehur në përqindje

Siç tregon grafiku, përqindja e rritjes së numrit të mungesave në mësim të nxënësve të shkollës fillore vjen duke u rritur. Shkaqet pse ndodh kështu mbeten të panjohura. Supozohet se mësimdhënësit e klasës së parë nuk mbajnë evidenca për mungesat e nxënësve në mësim. Por kjo nuk ndodh edhe në klasat tjera, sidomos kur shihet diferenca mes klasave 1 dhe 5. Bazuar në statistikat e (MAShT 2017/18, 2018, f. 32), në nivel vendi në klasën e parë kanë qenë 27406 nxënës. Sipas kësaj, i bie që secili nxënës i klasës së parë ka nga 3.09 mungesa, ndërsa në klasën e dytë nga 3.61 mungesa për kokë nxënësi. Mirëpo në klasën e pestë shifra është 4.43 mungesa për kokë nxënësi. Nëse i krahasojmë mungesat ndërmjet klasës pestë dhe klasë së gjashtë, diferenca është për 95218 mungesa. Derisa në klasën pestë kemi 4.43 mungesa për kokë nxënësi, por në klasën e gjashtë kemi 7.9 mungesa për kokë nxënësi. Kjo shifër rritet edhe më në klasën e nëntë, ku kemi 379384 mungesa, që për kokë nxënësi i bie nga 13.23 mungesa ose rreth 23% e totalit të mungesave.


Siç tregohet në grafikun 6, edhe në shkollën e mesme të ulët, sikurse në shkollën fillore, grafiku i mungesave rritet nga klasa më e ulët kah klasa më e lartë.



Grafiku 7

Mungesat sipas klasave, shkolla e mesme e ulët - në nivel vendi

Diferenca mes mungesave të nxënësve të klasës VI me nxënësit e klasës IX është për 167557.



Grafiku 8

Krahasimi i mungesave të nxënësve të klasave 1-5 dhe 6-9, në nivel vendi

Grafiku krahasues tregon trendin e mungesave nga niveli më i ulët kah më i larti, se si rritet përqindja e tyre. Dallimi midis mungesave të nxënësve në klasën e parë dhe nxënësve në klasën është i vogël, por kjo vjen duke u rritur nga klasa në klasë. Në nivelin fillor 23% të mungesave i kanë bërë nxënësit e klasës së pestë, si klasa më e lartë në shkollën fillore, ndërsa në nivelin e mesëm të ulët 33% të mungesave i kanë bërë nxënësit e klasës së fundit, klasës së nëntë.

Kalimi nga klasa e pestë në klasë të gjashtë tregon një stabilizim, edhe pse kjo fazë kalimi është goxha problematike. Nga ky kalim shihet rënie e mungesave, nga 23% në 19% në klasën e pestë.

Tabela 7

Kahet e lëvizjes së numrit të nxënësve – vitet e fundit

Nxënës për klasë										
Klasa	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
2017/2018	26844	26004	26185	26379	26041	26322	27004	27761	28242	240782
2018/2019	27426	25998	25422	25709	25800	25675	25689	26526	26916	235161
Dallimi	+ 582	-6	-736	-670	-241	-647	-1315	-1235	-1326	-5626

Siç tregohet në tabelë, me përjashtim të klasës së parë, në të gjitha klasat e tjera kemi rënie të numrit të nxënësve për klasë. Për dallim nga viti shkollor 2017/2018, ku dallimi midis hyrjes në klasë të parë, hyrje (26844), dhe daljes, klasa IX (28242), është negativ për 1398 nxënës, më shumë dalje sesa hyrje, në vitin shkollor 2018/2019 ka një dallim pozitiv në hyrje, klasa e parë, për 510 nxënës.

Tabela 8

Dallimet ndërmjet hyrjes dhe daljes nga klasa në klasë

2017/2018	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Nxënës	26844	26004	26185	26379	26041	26322	27004	27761
2018/2019	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nxënës	25998	25422	25709	25800	25675	25689	26526	26916
Diferenca	- 848	- 582	- 476	- 579	- 366	- 633	- 478	- 845

Tabela tregon diferencën e kalimit nga klasa në klasë. Kjo diferencë është e lartë në kalimin nga klasa e parë në klasën e dytë, minus 848 nxënës, ndërsa nga klasa VIII në klasën IX mungojnë 845. Prandaj, këto lëvizje, kalimi nga klasa paraprake në klasën vijuese, nuk dihet nëse (4807) janë përsëritës apo e kanë ndërprerë shkollimin. Të dhënat e SMIA/ASK (2019) nuk raportojnë

të dhëna për numrin e përsëritësve. Shikuar sipas komunave, vetëm dy vitet e fundit, (2018-2019), të dhënat tregojnë për rënie të numrit të nxënësve, me përjashtim të tri komunave: F. Kosovë, (398), Obiliq (11) dhe Junik (1).

I përmendëm këto të dhëna për të supozuar se mos numri kaq i madh i mungesave ndërlidhet me numrin e nxënësve, të cilët mungojnë në sistem! A ndodh që ata të raportohen në SMIA si numër ekzistues, por që shënohen se kanë munguar në mësim? Këto, dhe dilema të tjera, do duhej të verifikoheshin në shkolla. Shih rekomandimet!

TREGUESIT SIPAS KOMUNAVE

Nga numri i përgjithshëm i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, në këtë studim janë përfshirë 75% prej tyre. Jo të gjitha shkollat e përfshira, që i janë përgjigjur kërkesës për ofrimin e të dhënave, i kanë dërguar të dhënat komplet, ashtu siç janë kërkuar. Disa nuk i kanë dërguar fare të dhënat për mungesat e nxënësve në mësim. Prandaj, objekt trajtimi, analize, janë të dhënat e ofruara. Të dhënat e siguruara nga burimet tjera janë të nevojshme për t'i krahasuar me gjendjen e të dhënave të deklaruara.

Për shkak të numrit të vogël të shkollave të dërguara, disa nga këto komuna nuk do të analizohen veç e veç, për arsye të mungesës së saktësisë. Prandaj, këtu prezantohen komunat me më shumë shkolla dhe të dhëna të dërguara.


Komuna e Deçanit

Sipas të dhënave të ASK/MASHT 2018, komuna e Deçanit nuk kishte asnjë fëmijë në institucionet parashkollore (0-5), ndërsa kishte gjithsej 505 fëmijë në klasën përgatitore (242 vajza dhe 263 djem) (MASHT/ASK, 2018, f. 14 &16).

Nxënës në shkollimin e detyrueshëm (1 deri në 9) kishte: 2146 djem (51%) dhe 2050 vajza, (49%) ose 4196 gjithsej. Në të dhënat statistike publike nuk japin të dhëna për numrin e nxënësve të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, por vetëm numrin e përgjithshëm.

Por, sipas të dhënave që shkollat i kanë dërguar, pasqyra e numrit të nxënësve të shkollës fillore në këtë komunë është si në grafik. Gjithsej në


këtë nivel janë 1464 nxënës, prej tyre 771 ose rreth 53% ishin djem dhe 693 vajza ose rreth 47%. Në nivel vendi ky raport është 52x48, për të dyja nivelet.



Grafiku 9

Numri i nxënësve në shkollimin fillor në komunën e Deçanit


Sa i përket strukturës gjinore të nxënësve të shkollës së mesme të ulët (VI-IX) në këtë komunë, thuhet se është e balancuar, 50 x50, me një tendencë të vogël të dominimit të vajzave. Edhe në këtë nivel, sikurse në nivelin fillor, vërehet një trend i rënies së numrit të nxënësve. Derisa në klasën IX kanë qenë 304 nxënës, në klasën VI janë 282, sikurse që shihet edhe në nivelin fillor, ku në klasën V ishin 293 nxënës, ndërsa në klasën e parë 288.



Grafiku 10

Numri i nxënësve sipas gjinisë në shkollën e mesme të ulët


Sa i përket vijimit, ose mungesës së nxënësve në mësim, gjendja pothuajse është e përafërt me shkollat tjera.



Grafiku 11

Mungesat sipas klasave, në nivel komune

Shprehur në përqindje, nxënësit e klasës IX kanë bërë më së shumti mungesa, 5944 ose 22% e numrit të përgjithshëm të mungesave në nivel komunal.



Grafiku 12

Numri i mungesave shprehur në përqindje, sipas klasave


Sic shihet në grafik, numri i mungesave në mësim rritet duke u rritur niveli e klasës ose i moshës së nxënësve. Në klasat I deri në V rritja është simbolike, nga 6% në 9%. I njëjti trend rritet edhe në nivelin e shkollimit të mesëm të ulët (VI –IX), por me një përqindje më të madhe, nga 11% në klasën VI në 22% në klasën e IX. Trendi thuajse është i njëjtë me atë në nivel vendi.

Karakteristikat e mësimdhënësve të komunës së Deçanit

Dy analiza të këtij treguesi janë bërë, përvoja në mësimdhënie dhe numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit në të dyja nivelet, I-V dhe VII-IX.

Shikuar sipas përvojës së mësimdhënësve, shihet si në vijim.


Sipas të dhënave, shihet dominimi i mësimdhënësve me përvojë deri në pesë vjet, relativisht të rinj. Shprehur në përqindje, në këtë shkallë janë 26% e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve. Me përvojë 30 deri 35 janë rreth 14% e mësimdhënësve që bien në nivelin e katërt, në nivel komune. Është inkurajues fakti se rreth 60% e mësimdhënësve të kësaj moshe janë në kuadër të përvojës me produktivitet të lartë, 5-16 vjet, ose shprehur në moshë diku rreth moshës 40-vjeçare.



Grafiku 13

Mësimdhënësit sipas përvojës, në nivel komune


Vetëm rreth 2% e mësimdhënësve janë me përvojë 36-40, sikurse edhe mbi 40 vjet (2%). Kjo e fundit është e njëjtë me përqindjen e kësaj shkalle përvojë (2%) në nivel vendi.



Grafiku 14

Krahasimi mësimdhënës lëndorë-mësimdhënës klasorë, sipas përvojës në mësimdhënie

Siç shihet në grafik, ekziston një dallim ndërmjet mësimdhënësve klasorë dhe mësimdhënësve lëndorë, sa i përket shkallës së përvojës.




Grafiku 15

Përqindja e mësimdhënësve sipas përvojës në mësimdhënie

Më shumti mësimdhënës (26%) kanë përvojë deri në pesë vjet, gjë që flet për një moshë mesatare relativisht të re. Në vendin e dytë janë mësimdhënësit me përvojë 6-10 vjet.


Mbi pesë trajnime i kanë ndjekur 49% e mësimdhënësve, asnjë trajnim ka deklaruar vetëm një mësimdhënës, ndërsa 3-5 trajnime i kanë ndjekur rreth 39% e mësimdhënësve të komunës së Deçanit.



Grafiku 16

Numri i trajnimeve të mësimeve të mësuesve


Përqindja e deklaruar e mësimeve të mësuesve është pak më e lartë me nivelin e përgjithshëm, pasi shumica kanë ndjekur mbi 5 trajnime, 49%, që është më e lartë se përqindja në nivel vendi, (43%), por është më e ulët se mësuesit e shkollës së mesme të ulët dhe e njëjtë me numrin e trajnimeve në nivel vendi, ku kemi 43% me 43% me mbi pesë trajnime. Edhe sa i përket numrit të trajnimeve 3-5 kemi një rritje, në krahasim me nivelin kombëtar të trajnimit të mësimeve të mësuesve, 31% me 23% në nivel kombëtar. Por, është më e lartë se mësuesit e shkollës së mesme të ulët, pasi kemi 49% me 3-5 trajnime.



Grafiku 17

Përqindja e numrit të trajnimeve të ndjekura nga mësuesit

Sa i përket numrit të trajnimeve të deklaruara nga mësime të shkollës së mesme të ulët të kësaj komune, është diçka mbi nivelin e vendit. Derisa në nivel vendi mbi 5 trajnime i kanë ndjekur rreth 43% e mësime të shkollës së mesme të ulët të Deçanit kjo është 49%, ndërsa në nivel vendi kemi 28% të mësime të shkollës së mesme të ulët që kanë ndjekur 3-5 trajnime, në Deçan është 31%. Gjithashtu, edhe në nivelin me 1-2 trajnime është më mirë sesa në nivel vendi (15% me 19%). Kjo flet për një përkushtim të mirë të nivelit komunal për zhvillim profesional të mësime të shkollës së mesme të ulët.




Grafiku 18

Trajnimi i mësime të shkollës fillore dhe të mesme të ulët – krahasim (Deçani)

Dallimi në numër këtu është rezultat i numrit më të madh të mësime të shkollave të mesme të ulëta, në krahasim me mësime të shkollës fillore. Por, kjo tregohet më mirë e shprehur në përqindje.

Komuna e Drenasit


Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), kishte gjithsej 8825 nxënës në shkollimin e detyrueshëm. Sipas të dhënave të ASK/MASHT, numri i nxënësve për klasë në këtë komunë është shumë i balancuar (dallimi nga klasa në klasë është i vogël). Vërehet një rënie në klasën e pestë, por hyrja dhe dalja, viti i mbledhjes së të dhënave, thuhet të jetë i njëjtë.



Grafiku 19

Numri i nxënësve për klasë në komunën e Drenasit


Për t'i krahasuar këto dallime, hyrje-daljet nga sistemi, duhet një analizë e statistikave për disa vjet. Edhe në përqindje janë 1-2%. Një lëvizje pak më e theksuar vërehet te nxënësit e klasës së pestë, por nuk ka të dhëna për një lëvizje të këtillë të nxënësve.



Grafiku 20

Përqindja e numrit të nxënësve për klasë në komunën e Drenasit


Për sa i përket numrit të mungesave, kahet janë të njëjta sikurse në nivel vendi. Trendi rritet nga klasa e parë në të nëntën. Edhe këtu thuajse kemi trefishim të mungesave në krahasim midis kufirit të poshtëm me kufirin më të lartë (6120 klasa e parë dhe 18268 klasa e nëntë).



Grafiku 21

Mungesat e nxënësve në mësim, në nivel komune


Siç shihet në grafik, shpërndarja e përqindjes së mungesave është gati e balancuar në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët.



Grafiku 22

Përqindja e mungesave për klasë, në nivel komune


Sikurse në nivel vendi, numri më i madh i mungesave në mësim është në klasën IX. Sa u përket mungesave në shkollimin fillor, kemi një përqindje të njëjtë, me përjashtim të klasës II, e cila ka një përqindje më të ulët.



Grafiku 23

Nxënësit e shkollës së mesme të ulët, sipas gjinisë

Në SHMU vërehet një dominim i djemve në raport me vajzat, që është i njëjtë me nxënësit e filltores (tabela 22). Ngjashëm ky raport është edhe në nivel vendi.



Grafiku 24


Struktura gjinore e nxënësve të shkollës filllore, në nivel komune

Sipas llogaritjes së numrit të nxënësve të kësaj komune, në shkollimin fillor janë 199 djem më shumë sesa vajza dhe 196 djem më shumë se vajza në

shkollën e mesme të ulët. Shprehur në përqindje, raporti djem-vajza është 48% vajza me afro 52% djem.

Mësimdhënësit

Bazuar në të dhënat e ASK/MAShT (2018), komuna e Drenasit ka gjithsej 657 mësimdhënëses, prej tyre 328 meshkuj dhe 329 femra. Por, bazuar në të dhënat e deklaruara nga shkollat, të dhënat ndryshojnë nga të dhënat zyrtare. Mund të ketë pasur ndonjë lëvizje, plus/minus, por që mund të jetë ngatërruar në të dhënat e deklaruara për mësimdhënësit që punojnë me klasë kolektive ose ata që punojnë në dy shkolla për plotësim norme. Përpunimi dhe prezantimi i të dhënave është sipas pasqyrës së deklaruar në formularin për hulumtim.




Grafiku 25

Mësimdhënësit sipas përvojës në mësimdhënie, niveli fillor dhe i mesëm i ulët

Siç shihet në grafik, numri më i madh i mësimdhënësve i takojnë përvojës 30 deri në 35 vjet, 171 ose 22% e të gjithë mësimdhënësve të komunës. Prej tyre 124 ose 22% e mësimdhënësve të shkollës së mesme të ulët, ose rreth 73% e të gjithë mësimdhënësve të këtij niveli të përvojës, ndërsa 27% prej


tyre janë mësimdhënës. Gjithashtu, me përvojë 36 deri në 40 vjet janë rreth 9% e mësimdhënësve të të dyja niveleve. Raporti mësimdhënës klasorë-mësimdhënës lëndorë këtu ndryshon, pasi tani kemi rreth 62% të mësimdhënësve që i takojnë këtij niveli të përvojës, në krahasim me 38% të atyre lëndorë. Rreth 19% e mësimdhënësve në nivel komune i takojnë këtij niveli të përvojës. Nëse kësaj i shtojmë edhe rreth 4% e mësimdhënësve që kanë mbi 40 vjet përvojë, atëherë del se rreth 23% e mësimdhënësve të kësaj komune janë në përfundim të karrierës.



Grafiku 26

Përqindja e mësimdhënësve sipas përvojës, në nivel komune


Tregues i mirë është se rreth 61% e mësimdhënësve, në të dyja nivelet, i përkasin përvojës 1 deri në 30 vjet, por edhe më i rëndësishëm është fakti se rreth 17% e mësimdhënësve i përkasin përvojës 6 deri në 10 vjet, si fazë e konsolidimit profesional, si dhe rreth 14% i përkasin përvojës 11 deri në 15 vjet, si fazë e arritjes optimale në karrierë.



Grafiku 27

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësime dhënësit e të dyja niveleve

Mësime dhënësit lëndorë kanë ndjekur 3 deri në 5 trajnime (42%) më shumë sesa mësime dhënësit klasorë (33%). Gjithashtu, mbi 50% e mësime dhënësitve lëndorë kanë ndjekur më shumë se 5 trajnime, në krahasim me mësime dhënësit klasorë (49%). Por, mësime dhënësit klasorë kanë më shumë 1 deri 2 trajnime (17%), në krahasim me mësime dhënësit lëndorë (6%).



Grafiku 28

Paraqitja e përqindjes së numrit të trajnimeve - krahasim

Sa u përket mësimdhënësve që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim, mësimdhënësit lëndorë qëndrojnë më mirë (1%) sesa mësimdhënësit klasorë, (2%) prej të cilëve nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Sa u përket treguesve të analizuar, në kontekstin komunal nuk vërehen dallime të rëndësishme me treguesit në nivel vendi.

Komuna e Rahovecit

Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), komuna e Rahovecit kishte 7506 nxënës në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (6-9). Me këta nxënës, sipas të dhënave ASK/MASHT (2018), në këtë komunë punojnë 590 mësimdhënës (346 ose rreth 59% meshkuj dhe 244 ose rreth 41% femra). Ndërsa, sipas të dhënave të grumbulluara, janë 525 ose rreth 90% e mësimdhënësve të përfshirë.


Tabela 10

Struktura e nxënësve të komunës së Rahovecit, sipas përbërjes gjinore

Klasa	M	F	Gjithsej
I	330	287	617
II	309	311	620
III	344	305	649
IV	356	311	667
V	371	333	704
VI	418	384	802
VII	436	399	835
VIII	479	442	921
IX	517	468	985
Krejt	3560	3240	6800

Siç shihet në tabelë dhe në grafik, numri i nxënësve në hyrje dhe dalje nga sistemi ka një rënie, ndërsa sipas strukturës gjinore kemi të njëjtin proporcion me atë në nivel vendi (52% djem me 48% vajza). Diferenca mes daljes (klasa IX) dhe hyrjes (klasa I) është për 368 nxënës më pak. Por, nuk


ka ndonjë dallim të rëndësishëm në hyrje-dalje nga sistemi sa i përket strukturës gjinore.



Grafiku 29

Nxënësit sipas klasës dhe gjinisë

Grafiku tregon rënien graduale të numrit të nxënësve për klasë. Dallimi midis hyrjes dhe daljes është për 368 nxënës më pak.




Grafiku 30

Përqindja e nxënësve për klasë në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët

Derisa në klasën IX kemi 15% të numrit të përgjithshëm të nxënësve, nga 6800 sa janë deklaruar, në klasën I kemi 9% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të komunës.

Sa u përket mungesave në mësim nga nxënësit e kësaj komune, gjendja është e përafërt me atë në nivel vendi dhe në komunat e tjera. Grafiku nga klasa e parë deri në të nëntën vjen duke u rritur. Përgjithësisht këtu bën klasa e shtatë, pasi numri i mungesave bie në krahasim me klasën e gjashtë, por edhe në krahasim me të dhënat në nivel vendi për këtë klasë.




Grafiku 31

Numri i mungesave në mësim, sipas klasës

Mesatarisht nga 6.9 mungesa për nxënës, ose për 190 mungesa më pak. Llogaritur në ditë mësimi, i bie që secili nxënës ka munguar, apo humbur, një ditë mësimi në vit.

Dallimi në përqindje në shpërndarjen e mungesave për klasë në të dyja nivelet gati është i balancuar, por që dallon midis niveleve. Kështu, derisa në klasën e parë është 4% e numrit të numrit të përgjithshëm të mungesave, në klasën e nëntë është 23%.



Grafiku 32

Shpërndarja e mungesave në përqindje për klasë, në nivel komune


Nxënësve të klasës së nëntë u bie nga 13.5 mungesa për nxënës, ose rreth dy ditë mësimi në vit të humbura për secilin nxënës.

Mësimdhënësit

Sipas të dhënave zyrtare të ASK/MAShT (2018), numri i mësimdhënëësve në arsimin e obligueshëm në komunën e Rahovecit ishte 590 (346 meshkuj dhe 244 femra). Rreth 59% ishin meshkuj dhe 41% femra. Ky proporcion nuk është në përputhje me nivelin shtetëror (44% meshkuj me 56% femra). Sipas të dhënave të deklaruara nga shkollat, numri i mësimdhënëësve në këtë komunë është 185 në arsimin fillor dhe 340 në arsimin e mesëm të ulët.


Edhe këtu është llogaritur struktura e mësimdhënëësve sipas përvojës në mësimdhënie, për të dyja nivelet, fillor dhe i mesëm i ulët.

Në grupin e përvojës (25 deri 30 vjet) është numri më i madh i mësimdhënëësve. Shprehur në përqindje, në këtë nivel përvojë janë 21% e mësimdhënëësve. Në vendin e dytë janë mësimdhënësit me përvojë (6 deri në 10 vjet) ose rreth 18%, ndërsa në vendin e tretë janë mësimdhënësit me përvojë (30 deri në 35 vjet) ose rreth 17%.



Grafiku 33


Struktura e mësimdhënësve sipas përvojës, në të dyja nivelet



Grafiku 34

Struktura e mësimdhënësve, sipas përvojës, e shprehur në përqindje

Përqindja e mësimdhënësve të të dyja niveleve është e njëjtë me atë në nivel vendi (2%).




Grafiku 35

Krahasimi i përvojës mësimdhënëse klasorë – mësimdhënëse lëndorë, shprehur në përqindje

Midis mësimdhënësve klasorë dhe mësimdhënësve lëndorë ka dallime të ndjeshme në disa nivele, siç është niveli mbi 40 vjet përvojë. Derisa vetëm 2% e mësimdhënësve lëndorë kanë mbi 40 vjet përvojë, kjo te mësimdhënësit e fillores është 4%. Pastaj rreth 17% e mësimdhënësve klasorë kanë përvojë 25-30 vjet, në krahasim me mësimdhënësit lëndorë 21%.


Trajnimet



Grafiku 36

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja niveleve

Në të gjitha trajnimet mësimdhënësit lëndorë kanë ndjekur numër më të madh të trajnimeve në krahasim me mësimdhënësit klasorë dhe ka më shumë mësimdhënës lëndorë që nuk e kanë ndjekur asnjë trajnim.



Grafiku 37

Krahasimi i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja niveleve


Mësimdhënësit lëndorë kanë më shumë se pesë trajnime të ndjekura (44%), në krahasim me mësimdhënësit klasorë (37%). Ndërsa mësimdhënësit klasorë kanë më shumë 3 deri 5 trajnime (45%) në krahasim me mësimdhënësit lëndorë (31%). Por, kemi përqindje më të lartë të mësimdhënës lëndorë që nuk e kanë ndjekur asnjë trajnim (8%), ndërsa vetëm 2% e mësimdhënësve klasorë nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Komuna e Gjakovës

Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), komuna e Gjakovës kishte 12332 nxënës (I-IX), si dhe 894 mësimdhënës (334 meshkuj dhe 560 femra).

Sipas të dhënave të deklaruara, nxënësit e kësaj komune kanë bërë gjithsej 111846 mungesa përgjatë një viti mësimor, ose rreth 11 mungesa për kokë nxënësi.


Trendi i rritjes së numrit të mungesave për klasë (nga klasa I në IX) është afërsisht me trendin në nivel vendi. Edhe këtu, sikurse në komunën e Rahovecit, klasa VII, por përjashtim bën klasa VIII, pasi numri i mungesave bie në krahasim me klasën paraprake. Edhe në klasën e pestë kemi një dukuri më specifike në krahasim me komunat e tjera. Numri i mungesave rritet për 4328 mungesa. Dallimi midis kufirit të poshtëm (klasa I) dhe kufirit të epërm (klasa IX) është për 19405 mungesa. Dallimi nuk është i vogël edhe ndërmjet klasës VIII dhe klasës IX, 7599 mungesa.



Grafiku 38

Raporti ndërmjet mungesave dhe numrit të nxënësve, sipas klasave, në nivel komune

Shprehur në përqindje, në grafikun 37 shihet se përqindjen më të lartë të mungesave e kanë bërë nxënësit e klasës IX (22%) dhe më pak nxënësit e klasës I, vetëm 5% të numrit të përgjithshëm të tyre.




Grafiku 39

Numri i mungesave për klasë shprehur në përqindje

Nxënësve të klasës së nëntë u bien rreth 17 mungesa për kokë nxënësi, ose rreth tri ditë mësimi të humbura gjatë një viti mësimor. Ndërsa në klasë të parë ka rreth 4 mungesa për kokë nxënësi, ose mesatarisht një ditë mësimi të humbur në vit për secilin nxënë, por rreth 9 mungesa për kokë nxënësi në klasën e pestë.


Mësimdhënësit



Grafiku 40

Mësimdhënësit sipas shkallës së përvojës, në nivel komune


Deri në një vit përvojë, mësimdhënës klasorë janë rreth 3%, ndërsa mësimdhënës lëndorë janë rreth 5%. Dallime tjera ka midis përvojës 6 deri në 10 vjet, me 21% të mësimdhënësve klasorë dhe 15% të mësimdhënësve lëndorë. Por mbi 40 vjet ka më shumë mësimdhënës klasorë (5%), në krahasim me mësimdhënësit lëndorë (1%). Ka një dallim të theksuar në nivelin 30-35 vjet, ku mësimdhënësit klasorë marrin pjesë me 7% në krahasim me mësimdhënësit lëndorë, 16%. Te nivelet e tjera të përvojës thuajse nuk kanë dallime të rëndësishme.



Grafiku 41


Përqindja e mësimdhënësve sipas përvojës në komunën e Gjakovës

Sa i përket numrit të trajnimeve për mësimdhënës, është afërsisht i përafërt me gjendjen në nivel vendi. Dallime të vogla vërehen ndërmjet mësimdhënësve lëndorë dhe mësimdhënësve klasorë sa i përket numrit të trajnimeve të ndjekura. Nuk ka asnjë mësimdhënës klasor pa asnjë trajnim. Ndërsa tek mësimdhënësit lëndorë janë 5% që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.



Grafiku 42

Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja niveleve



Grafiku 43

Numri i trajnimeve shprehur në përqindje, për të dyja nivelet


Të dyja palët kanë ndjekur në përqindje të njëjtë 3 deri në pesë trajnime (23%), ndërsa mbi pesë trajnime i kanë ndjekur 69 % mësimitdhënësit klasorë, në krahasim me mësimdhënësit lëndorë, 62%. Një diferencë të vogël midis tyre e kemi edhe te përqindja 1 deri në 2 trajnime.

Komuna e Ferizajt

Nga kjo komunë nuk i kanë dërguar të gjitha të dhënat për shkolla. Mungojnë të dhënat për mungesat e nxënësve. Sipas ASK/MASHT (2018), kjo komunë i ka 16323 nxënës në shkollimin 1-9. Po sipas të njëjtit burim, numri i mësimdhënësve në shkollimin e detyrueshëm është 1127 (femra 703, ndërsa meshkuj 424). Sipas këtij burimi, rreth 62% e mësimdhënësve të kësaj komune janë femra dhe 38% meshkuj, përqindje pak më e ulët sesa në komunën e Gjakovës.

Nxënësit

Numrin e nxënësve sipas klasave në nivel komune e tregon grafiku. Sipas grafikut, shihet se kemi një shpërndarje shumë të balancuar të nxënësve. Ndryshimi midis kufirit të ulët dhe kufirit të sipërm është i vogël (88 nxënës më pak në kufirin e poshtëm).



Grafiku 44

Shpërndarja e numrit të nxënësve për klasë


Bazuar në këto të dhëna, vërehet një rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve në hyrje në sistemin arsimor. Ky trend thuajse është i përafërt në të gjitha komunat e vendit.

Mësimdhënësit

Në analizë janë përfshirë vetëm 12 shkolla të kësaj komune, prandaj të dhënat vlejné vetëm për këtë mostër.


Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), me 16323 nxënës në shkollimin e detyrueshëm punojné gjithsej 1127 mësimdhënëës. Sipas këtyre të dhënave, raporti mësimdhënëës – nxënës është 1x14.5. Si tregues statistikor është i rëndësishëm, por kjo nuk vlen për të gjitha shkollat.

Sipas të dhënave të grumbulluara, të deklaruara nga këto 12 shkolla, kemi këtë gjendje të mësimdhënëësve sipas përvojës dhe trajnimeve të ndjekura.



Grafiku 45

Mësimdhënësit sipas përvojës në nivel komune, të përfshirë në mostër




Grafiku 46

Përvoja e mësimdhënësve/mësimdhënësve – krahasim

Rreth 21% e mësimdhënësve klasorë dhe 20% e mësimdhënësve lëndorë kanë 6-10 vjet përvojë, ndërsa 19% e mësimdhënësve lëndorë kanë deri në pesë vjet përvojë, në krahasim me mësimdhënësit klasorë, që janë vetëm 10%. Gjithashtu, 10% e mësimdhënësve klasorë kanë 36-40 vjet përvojë në krahasim me mësimdhënësit lëndorë, vetëm 4%. Ndërsa, rreth 5% e klasorëve kanë mbi 40 vjet përvojë në krahasim me lëndorët, 2%. Prandaj, mësimdhënësit klasorë të kësaj komune janë më të moshuar sesa mësimdhënësit lëndorë.

Trajnimet



Grafiku 47

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit, shprehur në përqindje


Sa i përket numrit të trajnimeve të ndjekura nga mësimitdhënësit e të dyja niveleve, kemi dallime të theksuara. Derisa vetëm 2% e mësimitdhënësve klasorë nuk kanë ndjekur asnjë trajnim, kjo shifër te mësimitdhënësit lëndorë është 6%. Por, 48% e mësimitdhënësve klasorë kanë ndjekur mbi pesë trajnime, ndërsa 27% e mësimitdhënësve lëndorë kanë ndjekur caq trajnime. Më shumë mësimitdhënës lëndorë kanë ndjekur 3 deri në 5 trajnime (45%), në krahasim me mësimitdhënësit klasorë, 31%.

Analiza e numrit të mungesave për nxënës për këtë komunë mungon, pasi që nuk janë raportuar në formularët e kërkuar.

Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës bën pjesë në komunat e reja. Gjendet në pjesën qendrore të Kosovës.

Sipas burimeve të ASK/MAShT (2018), kjo komunë në shkollimin e detyrueshëm (1-9) ka gjithsej 9328 nxënës.



Grafiku 48

Numri i nxënësve nëpër klasë, sipas të dhënave zyrtare

Numri i nxënësve nëpër klasë në nivel komunë është shumë i balancuar.


Shihet një rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve nga hyrjet dhe daljet në sistem.



Grafiku 49

Përqindje tejet e balancuar e numrit të nxënësve për klasë, në nivel komune

Ky balancim i numrit të nxënësve nëpër klasë në nivel komune është i veçantë. Gjithashtu, kjo tregon ruajtjen aktuale të numrit të nxënësve, por edhe mungesën e shtimit të numrit të nxënësve. Kjo balancë e numrit të nxënësve nuk është e njëjtë në shpërndarjen e mungesave. Brenda një viti mësimor, nxënësit e kësaj komune (klasat I-IX) kanë bërë gjithsej 55527 mungesa në orë mësimi.




Grafiku 50

Mungesat e nxënësve për klasë në nivel komune

Këtu kemi një gjë të veçantë, në krahasim me komunat e tjera: nxënësit e klasës së parë kanë bërë më shumë mungesa sesa nxënësit e klasave II-V.

Ndërsa te nxënësit e shkollës së mesme të ulët është i njëjti trendi me shkollat e tjera.




Grafiku 51

Përqindja e mungesave, shpërndarja për klasë

Shprehur në përqindje, edhe këtu nxënësit e klasës IX dallohen me numër më të madh të mungesave në mësim, 20% e numrit të përgjithshëm. Nga klasa e gjashtë numri i mungesave rritet. Ndërsa numrin më të ulët të mungesave në mësim e kanë nxënësit e klasës së tretë, vetëm 6%.


Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), Malisheva ka 795 mësimdhënës (1-9), 505 meshkuj dhe 290 femra.




Grafiku 52

Mësimdhënësit sipas përvojës, të dyja nivelet- Malishevë

Përçindja e mësimeve sipas përvojës- Malisheva



Përvoja e mësuesve në përçindje - Mlaisheva




Grafiku 53

Përçindja e mësimeve sipas përvojës, krahasimi mësimeve klasorë – mësimeve lëndorë

Përçindja e shpërndarjes së mësimeve sipas përvojës dallon në disa shkallë. Deri në një vit përvojë ka më shumë mësimeve klasorë sesa lëndorë, por gjithashtu më shumë ka edhe në ekstremin tjetër, mbi 40 vjet përvojë, 7%, në krahasim me mësimeve lëndorë, rreth 2%. Gjithashtu, dallime të theksuara vërehen edhe sa i përket përvojës deri në 5 vjet. Derisa në këtë nivel përvojë janë 22% e mësimeve lëndorë, kjo te klasorët është 6%.


Trajnimet



Grafiku 54

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimeve lëndorë e të dyja niveleve

Siç shihet në grafik, mësime të ndjekur të kësaj komune kanë ndjekur më shumë trajnime në krahasim me mësime të ndjekur klasorë. Po ashtu, ka më shumë lëndorë që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim, në krahasim me mësime të ndjekur klasorë (8 x 45). Në të gjitha të tjerat prijnë mësime të ndjekur lëndorë.




Grafiku 55

Numri i trajnimeve shprehur në përqindje - krahasim

Më së shumti mësime të ndjekur kanë ndjekur 3-5 trajnime (41% e mësime të ndjekur klasorë dhe 37% e mësime të ndjekur lëndorë të komunës). Në vendin e dytë renditen mësime të ndjekur e të dyja niveleve, me mbi pesë trajnime.

Komuna e Fushë-Kosovës

Numri i nxënësve (1-9), sipas raportit statistikor ASK/MAShT (2018), ishte 6270 nxënës. Meqenëse kjo komunë është pritëse e një numri të vazhdueshëm të banorëve dhe nxënësve, ky numër ndërron në vazhdimësi.



Grafiku 56

Numri i nxënësve nëpër klasë, në nivel komune

Siç tregon grafiku, ka një dallim në hyrje dhe dalje në sistemin e shkollimit. Dallimi midis hyrjes (klasa I) dhe daljes (klasa IX) është 240 nxënës.




Grafiku 57

Përfaqësimi në përqindje i nxënësve nëpër klasë, në nivel komune, Fushë-Kosovë

Sikurse në komunën e Malishevës, edhe këtu kemi një shtrirje të balancuar të numrit të nxënësve për klasë. Përjashtim bën klasa e parë, me 14% të numrit të nxënësve.

Raporti mësimdhënës (282) nxënës (6270) është rreth 22 nxënës për mësimdhënës.


Mungesat në mësim



Grafiku 58

Numri i mungesave në mësim, të shpërndara për klasë

Siç shihet në grafik, kemi një shpërndarje interesante të mungesave, krahasuar me komunat e tjera. Në ciklin fillor kemi ngritje dhe rënie të numrit të mungesave, kurse në shkollimin e mesëm të ulët kemi vetëm ngritje. Sikurse në komunat e tjera, dallimi midis kufirit të poshtëm, klasa e parë, dhe kufirit të epërm, klasa e nëntë, është shumë i madh (13623), ose gati 1 me 5. Nxënësit e kësaj komune kanë bërë gjithsej 73589 mungesa, ose rreth 11.7 mungesa për kokë nxënësi. Ndërsa, mesatarisht nxënësit e klasës IX kanë bërë nga 117 mungesa për nxënësi.




Grafiku 56

Përqindja e shpërndarjes së mungesave për klasë

Përqindja më e lartë e mungesave është te nxënësit e klasës IX (24%), pasuar nga ata të klasës VIII (20%).


Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), komuna e Fushë-Kosovës ka gjithsej 282 mësimdhënës, në të dyja nivelet e shkollimit të detyrueshëm (I - IX). Struktura gjinore e tyre është 36% meshkuj dhe 64% femra.



Grafiku 57

Shpërndarja e mësimdhënësve sipas përvojës, në të dyja nivelet


Më shumë mësimdhënës (6-9) i përkasin përvojës më të re, 1-20 vjet, në krahasim me mësimdhënësit klasorë. Gjithashtu, nuk ka asnjë mësimdhënës me përvojë mbi 40 vjet, ndërsa janë 12 mësimdhënës klasorë të kësaj përvoje. Rreth 30% e mësimdhënësve kanë mbi 30 vjet përvojë, ose mbi 50 vjet moshë. Kjo tregon për një mesatare moshe të shtyrë në mësimdhënie.



Grafiku 58

Mësimdhënësit sipas përvojës, shprehur në përqindje - krahasim

Trajnimet




Grafiku 59

Numri i trajnimeve të ndjekura nga ana e mësimdhënësve, të të dyja niveleve

Në të gjitha nivelet e trajnimit prijnë mësime të mësimdhënësve të lëndorë, në krahasim me mësime të mësimdhënësve të klasorë. Po ashtu, ka numër më të madh të mësime të mësimdhënësve të cilët nuk kanë ndjekur asnjë trajnim, gjithsej 17, ose rreth 10% prej tyre. Ndërsa ky numër te klasorët është dukshëm më i vogël, 7, ose rreth 6%.

Në të dyja nivelet e mësime të mësimdhënësve shumica kanë ndjekur më shumë se 5 trajnime.




Grafiku 60

Përqindja e trajnimeve të ndjekura nga mësime të mësimdhënësve – krahasim

Në krahasim me numrin e përgjithshëm të mësime të mësimdhënësve, ata kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime, krahasuar me mësime të mësimdhënësve të 6-9. Për këtë komunë brengosin numri shumë i madh i mungesave të nxënësve të klasës IX dhe numri i mësime të mësimdhënësve që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit bën pjesë në komunat e mëdha në Rajonin e Anamoravës. Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), kjo komunë kishte 11655 nxënës në shkollimin e detyrueshëm (1-9) dhe 979 mësime të mësimdhënësve.



Grafiku 61

Shpërndarja e nxënësve për klasë, në nivel komune

Edhe në këtë komunë kemi një dallim midis kufiritit hyrës dhe dalës, më i madh në dalje (IX)


sesa në hyrje (klasa I) për 224 nxënës.



Grafiku 62

Shpërndarja e nxënësve në përqindje


Siç tregohet në grafik, kemi një shpërndarje të balancuar të numrit të nxënësve nëpër klasë. Përqindje më të ulët të pjesëmarrjes kanë klasat II dhe V, 10%.



Grafiku 63

Mungesat e nxënësve në vit, në nivel komune


Brenda vitit nxënësit e kësaj komune kanë bërë gjithsej 23860 mungesa, rreth 4 mungesa për nxënësit e përfshirë në mostër (5800) ose rreth 2 mungesa për të gjithë nxënësit (gjithsej 11655) e komunës.



Grafiku 64

Numri i nxënësve dhe i mungesave vjen duke u rritur

Siç shihet në grafik, kemi një rritje-rënie të numrit të nxënësve dhe të mungesave. Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), raporti mësimdhënës (979) nxënës (11655) në këtë komunë është rreth 11.9 nxënës. Ndërsa në mostër janë përfshirë gjithsej 10 shkolla. Shpërndarja e mungesave vlen për mostër (5800), jo për numrin e përgjithshëm të nxënësve.




Grafiku 65

Trendi i mungesave shprehur në përqindje, sipas klasave

Edhe këtu kemi një shpërndarje afërsisht të ngjashme me komunat e tjera. Kemi një veçanti këtu, pasi nxënësit e klasës VIII kanë bërë më shumë mungesa sesa nxënësit e klasës IX, sikurse edhe në klasën V, ku nxënësit kanë bërë më shumë mungesa në krahasim me nxënësit e klasës VI.

Mësimdhënësit


Të dhënat për mësimdhënësit e kësaj komune nuk janë të plota, pasi që nuk kemi arritur t'i përfshijmë të gjitha shkollat. Të dhënat vlejnjë vetëm për mostrën, 442 mësimdhënës.



Grafiku 66

Mësimdhënësit e përfshirë në mostër, sipas përvojës

Sipas të dhënave, më së shumti mësimdhënësit kemi me 6-10 vjet përvojë, pastaj 25-30 vjet dhe 16-20 vjet.




Grafiku 67

Përqindja e mësimdhënësitve sipas përvojës - krahasim

Sa i përket përqindjes sipas përvojës, kemi dallime të vogla midis mësimdhënësitve (1-5) dhe mësimdhënësitve (6-9). Këto dallime vërehen vetëm te përvojat deri në 5 vjet, 11 deri 15, dhe 25-30 e 30-35. Përqindja e dallimit është e ulët. Kështu që mësimdhënësit e të dyja niveleve, shikuar sipas përvojës, nuk kanë dallime të mëdha.


Trajnimet



Grafiku 68

Trajnimet e ndjekura nga ana e mësimdhënësve, në të dyja nivelet

Në të gjitha rastet mësimdhënësit (6-9) kanë ndjekur më shumë trajnime në krahasim me mësimdhënësit (1-5). Dallimi më i madh është te niveli 3 deri në 5 trajnime. Ndërsa asnjë shkollë nuk ka raportuar se kanë mësimdhënës pa asnjë trajnim të kryer.




Grafiku 69

Përqindja e pjesëmarrjes në trajnime – krahasim

Dallime të dukshme shihen midis shkallës më të lartë të trajnimeve (3 deri në 5) të mësimit, 15% e mësimit klasorë dhe 26% e mësimit lëndorë, si dhe me mbi 5 trajnime dominojnë klasorët, me 77%, në krahasim me mësimit lëndorë, 66%.

Komuna e Kaçanikut


Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), komuna e Kaçanikut kishte 4637 nxënës dhe 371 mësimit, 208 meshkuj dhe 161 femra, ose 43% femra dhe 57% meshkuj.



Grafiku 70

Shtrirja e numrit të nxënësve për klasë, në nivel komune


Ngjashëm sikurse në komunat e tjera, vërehet trend i rënies së numrit të nxënësve në fazën e hyrjes, klasa I, në krahasim me daljen, klasa IX. Këtu kemi rreth 100 nxënës më pak.



Grafiku 71

Përqindja e shpërndarjes së nxënësve për klasë, në nivel komune


Siç tregon grafiku, kemi një shpërndarje shumë të balancuar të nxënësve për klasa. Ka një rritje simbolike në klasën IX dhe një ulje në klasën III.



Grafiku 72

Numri i mungesave të nxënësve sipas klasave, në nivel komune

Siç shihet në grafik, numri i përgjithshëm i mungesave në nivel komune është gjithsej 38914 mungesa, 4637 nxënës, ose mbi tetë mungesa për kokë nxënësi. Nxënësit e klasës VIII më së shumti kanë munguar në mësimet (7327 mungesa).



Grafiku 73

Mungesat e nxënësve në mësimet, shprehur në përqindje, sipas klasave

Trendi i mungesave thuhet të jetë i njëjtë me komunat e tjera. Më i ulët në fillorë dhe shkon duke u rritur në shkollën e mesme të ulët. Dallimi midis kufirit të poshtëm, klasa I, dhe kufirit të epërm, klasa IX, është për 4975 mungesa. Nxënësit e klasës IX kanë mesatarisht nga 11.7 mungesa për nxënësi, ndërsa ata të klasës I rreth 4 mungesa për nxënësi. Përkrah nxënësit të klasës VIII, me rreth 14.5 mungesa për nxënësi.


Mësimdhënësit

Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), komuna e Kaçanikut kishte gjithsej 371 mësimdhënësi në shkollimin e detyrueshëm (I-IX). Struktura gjinore, rreth 44% femra dhe 56% meshkuj. Rreth 12.5 nxënës për mësimdhënësi, përqindje e përafërt me raportin në nivel vendi, rreth 13.8 nxënës për mësimdhënësi.

Të dhënat e mbledhura, të deklaruar nga shkollat, dallojnë nga ato të raportuara nga ASK/MASHT (371), në 328


Nuk ka të dhëna nëse ky numër ka ndryshuar, apo nuk është raportuar sikurse në ASK.

Siç tregon grafiku, më së shumti mësimdhënës i përkasin përvojës 25-30 (67 ose rreth 20%) dhe më së paku mbi 40 vjet, vetëm 7. Është inkurajuese përvoja deri 5, 11 dhe deri 15 vjet, të cilët përfaqësojnë një përqindje relativisht të mirë. Njihet si mosha produktive.



Grafiku 74


Struktura e mësimdhënësve, sipas përvojës, në të dyja nivelet



Grafiku 75

Mësimdhënësit sipas përvojës, shprehur në përqindje - krahasim


Ndërmjet mësimeve të nivelit 6-9 dhe mësimeve 1-5 ka dallime të theksuara sa i përket përqindjes sipas përvojës. Numri më i madh i mësimeve lëndore i takon përvojës 25-30 (23%), ndërsa të mësimeve klasore 17%, por kemi 18% të lëndoreve që kanë përvojën 11 deri 15 vjet, në krahasim me mësimeve klasore, 11%. Përqindje më të lartë kemi të mësimeve me përvojë mbi 36 vjet, por kemi 9% mësimeve klasore të rinj, deri në 1 vit, në krahasim me mësimeve të nivelit 6-9, vetëm 3%. Të dhënat për të dyja nivelet flasin për një heterogjenitet sa i përket strukturës së mësimeve sipas përvojës.



Grafiku 76

Numri i trajnimeve të ndjekura nga ana e mësimeve, në të dyja nivelet

Në të gjitha rastet mësimeve lëndore kanë ndjekur më shumë trajnime në krahasim me mësimeve klasore. Sikurse në komunat e tjera, edhe këtu prijnë lëndoret me mbi 5 trajnime, ose rreth 47% e mësimeve të të dyja niveleve.




Grafiku 77

Numri i trajnimeve, shprehur në përqindje – krahasim

Bazuar në numrin e mësimeve, klasorët kanë më shumë se 5 trajnime (56%), në krahasim me mësimeve lëndorë (43%). Ndërsa mësimeve lëndorë kanë dyfish më shumë 1 deri 2 trajnime (26%), në krahasim me mësimeve klasorë (13%). Të tjerat janë të balancuara.


Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës bën pjesë në rajonet në të cilat ka lëvizje të mëdha të nxënësve. Numri i nxënësve thuajse në çdo periudhë raportimi ndryshon (bie). Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), numri i nxënësve (1-9) në këtë komunë ishte 3351, ndërsa mësimeve janë 420. Bazuar në këtë raport, për një mësimeve kemi rreth 8 nxënës.



Grafiku 78


Numri i nxënësve për klasë, në nivel komune



Grafiku 79

Përqindja e nxënësve për klasë


Gjithsej 29185 mungesa në nivel komune, ose rreth 8.7 mungesa për kokë nxënësi, në nivel komune.



Grafiku 80

Mungesat në mësim sipas klasave


Shikuar sipas klasave, sikurse në komunat e tjera, nxënësit e klasës IX kanë bërë më shumë mungesa, rreth 20 mungesa për nxënës, ose 29% e numrit të përgjithshëm të mungesave, dhe më pak klasa I, rreth 4 mungesa për nxënës, ose 4%.



Grafiku 81

Shpërndarja e mungesave për klasë, shprehur në përqindje

Ngjashëm me komunat e tjera, edhe këtu kemi dallim shumë të madh ndërmjet kufirit të poshtëm, klasa I, dhe kufirit të epërm, klasa IX, 4% me 29%, ose 7197 mungesa më shumë.




Grafiku 82

Rritja enorme e numrit të mungesave të nxënësve në mësim

Mësimdhënësit


Siç është cekur më lart, Kamenica kishte 420 mësimdhënës në shkollimin e detyrueshëm. Raporti mësimdhënës – nxënës në këtë komunë është shumë i ulët, (1x8), bile ky raport shkon duke u zvogëluar, për shkak të rënies së numrit të nxënësve dhe migrimit.



Grafiku 83

Struktura e mësimdhënësve, sipas përvojës, në nivel komune


Numri më i madh i mësimdhënësve është me përvojë 11-15 vjet (68), pastaj 25-30 vjet (56) dhe më pak mësimdhënës kemi sipas përvojës deri në 1 vit. Sipas të dhënave të deklaruara, asnjë mësimdhënës nuk e kemi me mbi 40 vjet përvojë. Kemi një balancim të mësimdhënësve sipas përvojës 16-20 (22x22). Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve i paraqitur këtu është në bazë të të dhënave të dërguara nga shkollat.



Grafiku 84

Përqindja e mësimeve sipas përvojës - krahasim

Sipas grafikut, shihet se mësimeve të nivelit 6-9 janë më me përvojë, në krahasim me mësimeve (1-5). Mësimeve të nivelit 6-9 ka më shumë me përvojë 11-5 vjet (22%), në krahasim me mësimeve të nivelit 6-9 (15%). Po ashtu edhe të grupet tjera.




Grafiku 85

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimeve të dyja niveleve

Siç shihet në grafik, është e vetmja komunë që ka kaq pak mësimdhënës me mbi 5 trajnime. Siç shihet, mësimdhënësit lëndorë kanë ndjekur më shumë trajnime në krahasim me mësimdhënësit klasorë.

Por, nuk ka asnjë mësimdhënës klasor pa asnjë trajnim, për dallim nga mësimdhënësit lëndorë, që janë 9.




Grafiku 86

Trajnimet e mësimdhënësve, shprehur në përqindje - krahasim

Mësimdhënësit kanë vetëm dy grupe trajnimesh të ndjekura. Klasorët 1 deri në 2 (44%) dhe 3 deri në 5 (56%), nuk ka pa asnjë trajnim, ndërsa lëndorët 1 deri 2 trajnime (31%) dhe 3 deri 5 (62%), vetëm 2% kanë mbi 5 trajnime. Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e kësaj komune është specifik nga komunat e tjera.

Komuna e Klinës

Komuna e Klinës bën pjesë në kuadër të komunave mesatare, si me numër të nxënësve ashtu edhe të mësimdhënësve. Sipas të dhënave të ASK/MAShT, të vitit 2018, Klina kishte 6015 nxënës në shkollimin e detyrueshëm dhe 431 mësimdhënës. Raporti mësimdhënës – nxënës është rreth 14 nxënës për mësimdhënës, që është i ngjashëm me raportin në nivel vendi.



Grafiku 87

Numri i nxënësve sipas klasave, në nivel komune - Klinë


Dallimi i numrit të nxënësve në hyrje-dalje nga sistemi nuk është shumë i theksuar, siç ishte në Kamenicë. Klina ka vetëm 66 nxënës më pak në hyrje, klasa I, në krahasim me daljen, klasa IX. Megjithatë, sikurse në komunat e tjera, rënia e numrit të nxënësve ka kahe pozitive. Një gjë e veçantë vërehet këtë komunë, rënie në klasat II-III dhe rritje në klasën I.



Grafiku 88

Përqindja e nxënësve për klasë, në nivel komune

Shpërndarja e nxënësve shprehur në përqindje është e baraspeshuar.



Grafiku 89

Trendi i mungesave për klasë, në nivel komune

Dallimi midis kufirit të poshtëm, klasa I, dhe kufirit të epërm është i ngjashëm me komunat e tjera, vjen duke u rritur. Këtu më specifik është numri i mungesave të nxënësve të klasës VIII, më i lartë sesa i nxënësve të klasës IX, për 75 mungesa. Ndërsa, ndryshimi midis kufirit të poshtëm dhe kufirit të lartë është për 5829 mungesa në mësim, nga 51918 sa i kanë bërë të gjithë nxënësit.



Grafiku 90

Mungesat sipas klasave, shprehur në përqindje


Përqindja e mungesave në ciklin fillor të shkollimit është shumë e balancuar dhe trendi i rritjes, sikurse në komunat tjera, vërehet në klasat e shkollimit të mesëm të ulët. Siç tregon grafiku 90, diku 19% e numrit të përgjithshëm të mungesave u takojnë nxënësve të klasës VIII. Numri i mungesave për kokë nxënësi në këtë komunë është 8.6 mungesa. Në krahasim me mungesat në nivel vendi dhe disa komuna tjera, nuk është shumë i lartë. Por, nëse nxënësit e një klase mbajnë mesatarisht 6 orë mësimore në ditë dhe kur këtë e përpjesëtojmë me numrin e nxënësve, kuptojmë sa ditë mësimi humbin gjatë një viti mësimor. Secili nxënës del që ka humbur nga 1.4 ditë mësimi. Nëse kjo shumëzohet me numrin e përgjithshëm të nxënësve, atëherë numri i ditëve mësimore të humbura është tejet i lartë (6015x1.4).

Mësimdhënësit

Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), komuna e Klinës ka 431 mësimdhënës, 237 meshkuj ose rreth 55% dhe 194 femra rreth 45%. Raporti mësimdhënës-nxënës është sikurse në nivel vendi, rreth 14 nxënës për mësimdhënës. Sipas të dhënave që kemi mbledhur, numri i mësimdhënësve është 445. Këto të dhëna i prezantojmë në përpunim.

Sa u përket karakteristikave të tjera demografike të mësimdhënësve të kësaj komune, nuk dallojnë shumë nga të dhënat e komunave të tjera.


Siç tregohet në grafik, dominojnë mësimdhënësit me përvojë 25-30-vjeçare, me një tendencë të përvojës së mësimdhënësve. Por, nuk kemi asnjë mësimdhënës me mbi 40 vjet përvojë, sikurse që janë vetëm 7 mësimdhënës.



Grafiku 91

Struktura e mësimdhënësve sipas përvojës, në nivel komune


Në vendin e dytë bëjnë pjesë mësime të grupit me përvojë 16-20 vjet. Grupet e mësimeve të tjerë janë shumë të balancuara. Përjashtim bën grupi 36-40.



Grafiku 92

Mësimeve sipas përvojës, shprehur në përqindje


Te të gjitha grupet e përvojës shihen dallime ndërmjet mësimeve klasorë dhe mësimeve lëndorë. Rreth 26% e klasorëve janë me përvojë 25-30 vjet, në krahasim me mësimeve lëndorë, 19%.



Grafiku 93

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimeve e të dyja niveleve

Në të gjitha grupet mësimdhënësit lëndorë kanë më shumë trajnime, por më shumë mësimdhënës të këtij niveli janë edhe që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim (18).




Grafiku 94

Përqindja e shpërndarjes së trajnimeve, krahasimi mësimdhënës lëndorë–mësimdhënës klasorë

Krahasuar me numrin e mësimdhënësve, të të dyja niveleve, mësimdhënësit klasorë kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime (54%), në krahasim me mësimdhënësit lëndorë (32%). Ndërsa, mësimdhënësit lëndorë kanë ndjekur më shumë 1 deri në 2 dhe 3 deri në 5 trajnime, në krahasim me klasorët.

Komuna e Lipjanit


Komuna e Lipjanit bën pjesë në mesin e komunave mesatare. Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), kjo komunë ka 8987 nxënës (1-9) dhe 681 mësimdhënës, ose rreth 13 nxënës për një mësimdhënës, afërsisht me mesataren e vendit.



Grafiku 95

Numri i nxënësve dhe i mungesave, sipas klasave, në nivel komune

Nga 127781 mungesa në orë mësimi, numri më i madh janë në klasën IX. Kjo dukuri është e përafërt me gjendjen dhe kahet në nivel vendi. Edhe në këtë komunë dallimi midis kufirit të poshtëm, klasa I, dhe atij të epërm, klasa IX, është shumë i madh, ose për 17921 mungesa. Por, ky dallim nuk është aq i madh sa i përket numrit të nxënësve, sikurse në disa komuna. Ky dallim është për 36 nxënës më shumë në dalje sesa në hyrje, ose mesatarisht një paralele. Shpërndarja e nxënësve për klasë është shumë e balancuar, nuk ka dallime të mëdha.




Grafiku 96

Përqindja e nxënësve dhe mungesave të nxënësve, sipas klasave

Vetëm 12% e nxënësve në nivel komune janë në klasën IX, por 20% e mungesave nga numri i përgjithshëm u takojnë nxënësve të klasës IX, ose nga 23.5 mungesa për kokë nxënësi të kësaj klase, apo rreth 14 mungesa për nxënës nga numri i përgjithshëm i mungesave.

Mësimdhënësit


Sipas të dhënave, komuna e Lipjanit kishte 681 mësimdhënëses në shkollimin e detyrueshëm (1-9), 334 femra dhe 347 meshkuj. Të dhënat e prezantuara janë të mbledhura nga shkollat dhe janë përfshirë rreth 50% e mësimdhënësesve të komunës, jo nga statistikat zyrtare: 193 mësimdhënëses dhe 144 mësimdhënëses (337) gjithsej.



Grafiku 97

Mësimdhënësit sipas përvojës, në të dyja nivelet, fillor dhe i mesëm i ulët

Sipas të dhënave, numri më i madh i mësimdhënësesve i përketin përvojës 25-30 vjet dhe 6-10 vjet përvojë, pastaj 30-35 vjet. Në të gjitha grupmoshat shihet se dominojnë mësimdhënësit, sidomos në grupin e nivelit më të ulët të përvojës, ku shihet një dallim i madh sa i përket përvojës. Pasi që numri i mësimdhënësesve të përfshirë në mostër është më i vogël, atëherë përqindja e tyre në grup-vite të përvojës ndryshon. Sipas kësaj, del se me përvojë 25-30 vjet janë 26% e mësimdhënësesve klasorë, në krahasim me 11% e mësimdhënësesve lëndorë, ndërsa në grup-përvojën 36-40 dominojnë lëndorët me 10%, në krahasim me klasorët, vetëm rreth 3%, dhe në grup-përvojën mbi 40 vjet janë 4% e mësimdhënësesve klasorë dhe vetëm 2% e mësimdhënësesve lëndorë.




Grafiku 98

Shpërndarja e shprehur në përqindje, sipas përvojës, në të dyja nivelet

Grafiku tregon dallimet në përqindjet e përvojës së mësimdhënësve të shkollimit të mesëm të ulët me mësimdhënësit e shkollimit fillor në nivel komunal.

Trajnimet



Grafiku 99


Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja niveleve

Mësimdhënësit klasorë kanë ndjekur mbi 5 trajnime më shumë sesa mësimdhënësit lëndorë. Me asnjë trajnim janë më shumë mësimdhënësit lëndorë sesa klasorë (30x11). Për shkak të dallimit në numër, këtë e tregon më mirë frekuenca e trajnimeve e shprehur në përqindje.

Komuna e Mitrovicës

Në bazë të të dhënave të ASK/MAShT (2017/2018), komuna e Mitrovicës kishte gjithsej 10996 nxënës në shkollimin e detyruar, ndërsa mësimdhënësit ishin 799 (m=234, F= 565).


Numri i nxënësve në raportin mësimdhënësit-nxënës është rreth 11 nxënës për një mësimdhënësit.



Grafiku 100

Nxënësit dhe mungesat në mësim, në nivel komune

Sikurse në komunat e tjera, numri i nxënësve për klasë nuk ka dallime të mëdha, por numri i mungesave në mësim është thuhet dukuri e njëjtë: vjen duke u rritur nga klasa më e ulët në klasën e fundit (IX). Specifik është dallimi shumë i madh midis klasave IV dhe V, kur numri i mungesave bie, për t'u ngritur shumë në klasën VI.



Grafiku 101


Përqindja e numrit të nxënësve dhe mungesave në nivel komune

Derisa nxënësit e klasës IX përbëjnë 11% të numrit të nxënësve, atyre u takojnë 23% e mungesave në mësim. Kjo dukuri thuhet se është e njëjtë në të gjitha komunat. Dallimi në hyrje-dalje në sistem është për 94 më shumë në hyrje sesa në dalje. Kështu nuk është edhe në komunat tjera.

Mësimdhënësit

Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), në arsimin e detyrueshëm (1-9) kjo komunë kishte gjithsej 799 (m=234, F= 565) mësimdhënëës, kurse në mostër kemi përpunuar 797 mësimdhënëës.


Sipas përvojës së deklaruar nga shkollat, struktura e mësimdhënëësve të shkollimit të detyrueshëm është si në grafik. Për disa nivele nuk kemi dallime të mëdha sipas përvojës së mësimdhënëësve të kësaj komune. Dallimi i lartë i mësimdhënëësve klasorë dhe lëndorë qëndron te përvoja deri në 5 vjet, ku kemi më shumë lëndorë sesa klasorë, pastaj 16-20 vjet, ku prijnë më shumë mësimdhënëës klasorë dhe 25-30 vjeç lëndorë dhe dallimi më i theksuar është te përvoja 36-40 vjeç, ku numri i mësimdhënëësve klasorë shihet dukshëm më i madh.



Grafiku 102

Mësimdhënësit sipas përvojës, në nivel komune

Pjesëmarrja e mësimdhënëseve sipas përvojës, e shprehur në përqindje, tregohet në grafik. Me përvojë mbi 30-vjeçare dominojnë mësimdhënësit, me 29%, derisa mësimdhënësit dominojnë në përvojën deri në 5 vjet (20%).




Grafiku 103

Mësimdhënësit sipas përvojës shprehur në përqindje - krahasim

Dallime të tjera shihen midis përvojës 25-30 vjet, ku kemi vetëm 5% të mësimdhënësve, ndërsa janë 18% e mësimdhënësve. Mbi 40 vjet përvojë kemi përqindje të përafërt, thuajse njëjtë me komunat e tjera, rreth 2%. Këta tregues janë të rëndësishëm, sidomos për shkollat dhe për politikat komunale, për arsimin gjegjësisht për planifikimin e kuadrit bazuar në moshën dhe përvojën e tyre.


Trajnimet

Siç shihet në grafik, në të gjitha mundësitë e trajnimeve dominojnë mësimdhënësit lëndorë, në krahasim me mësimdhënësit klasorë. Ndërsa, sa i përket kategorisë asnjë trajnim dominojnë mësimdhënësit lëndorë, pasi 11 nuk kanë asnjë trajnim, në krahasim me klasorët, vetëm 1 i deklaruar.



Grafiku 104

Numri i trajnimeve të ndjekura nga të dyja palët, në nivel komune




Grafiku 105

Përqindja e trajnimeve të ndjekura, krahasimi në përqindje - Mitrovica

Bazuar në raportin mësimeve të mësimdhënësve – mësimeve të klasorëve, ku klasorët janë më pak, del që pjesëmarrja e tyre në trajnime të jetë në përqindje më të lartë. Grafiku paraqet raportin mes tyre, të shprehur në përqindje, sipas numrit të trajnimeve të ndjekura nga të dyja palët.

Komuna e Pejës


Komuna e Pejës bën pjesë në komunat e mëdha. Sipas të dhënave të MASH/ASK, në vitin shkollor 2017/2018 kishte gjithsej 13021 nxënës, në shkollimin e detyrueshëm (1-9) dhe 904 mësimeve të mësimdhënësve (m=234 dhe f=565). Raporti nxënës-mësimeve të mësimdhënësve ishte 14.4 nxënës për një mësimeve të mësimdhënësve.



Grafiku 106

Raporti numër i nxënësve – mungesa, sipas klasave, në nivel komune

Siç tregohet në grafik, kemi një balancë midis klasave sa i përket numrit të nxënësve, por mospërputhje midis numrit të nxënësve dhe mungesave në mësim, sipas klasave.




Grafiku 107

Përqindja e nxënësve dhe mungesave, sipas klasave

Nga gjithsej 59335 mungesa, rreth 5 mungesa për kokë nxënësi, 22% ose 40 mungesa për kokë nxënësi i kanë bërë nxënësit e klasës IX. Sa i përket numrit të nxënësve në hyrje–dalje në sistem, ka një dallim të vogël, për 41 nxënës më pak në hyrje, klasa I, në krahasim me daljet, klasa IX. Ky është një trend thuajse i ngjashëm në nivel vendi, me pak përjashtime.

Mësimdhënësit


Komuna e Pejës në vitin shkollor 2018/2018 kishte 904 mësimdhënëses (m=234 dhe f=565) në shkollën fillore dhe të mesme të ulët. Kemi mbledhur vetëm rreth ½ e të dhënave për mësimdhënësit e kësaj komune, pasi që disa shkolla nuk i kanë dërguar. Rezultatet vlejné vetëm për këta mësimdhënëses.



Grafiku 108

Mësimdhënësit sipas përvojës, krahasimi

Bazuar në numrin sipas mostrës, mësimdhënësit (6-9) del të jenë më të moshuar, me përjashtim të përvojës mbi 40 vjet, pasi mësimdhënësit klasorë janë dukshëm më shumë. Grafiku tregon se si është shpërndarja në përqindje te të dyja grupet.




Grafiku 109

Dallimet në përqindje - krahasimi

Dallimet mësimdhënës klasorë – mësimdhënës lëndorë sa i përket përvojës në mësimdhënie janë të dukshme në grafik. Dallimet më të theksuara shihen te përvoja 25-30 vjet, ku janë 17% e mësimdhënësve lëndorë, në krahasim me 10% të mësimdhënësve klasorë. Gjithashtu, 8% e mësimdhënësve klasorë janë me përvojë mbi 40-vjeçare, në krahasim me lëndorët, më pak se 1%.


Trajnimet



Grafiku 110

Numri i trajnimeve të deklaruara nga mësimdhënësit në nivel komune (mostra)

Siç tregohet në grafik, me numrin e trajnimeve të ndjekura dominojnë mësimdhënësit e nivelit 6-9, në krahasim me mësimdhënësit 1-5. Po ashtu, me asnjë trajnim të ndjekur ka më shumë mësimdhënës 6-9 sesa mësimdhënës të nivelit 1-5.




Grafiku 111

Përqindja e numrit të trajnimeve, sipas pjesëmarrjes – krahasimi

Sipas grafikut, kemi një shpërndarje të baraspeshuar sa i përket përqindjes së numrit të trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja grupeve.

Komuna e Podujevës


Sipas të dhënave të ASK/MAShT 2018, komuna e Podujevës në shkollimin e detyrueshëm kishte gjithsej 13263 nxënës (1-9) dhe 943 mësimdhënëës (m=234 dhe f=565). Rreth 14 nxënës për një mësimdhënëës, sikurse në komunat mesatare të Kosovës.



Grafiku 112

Shpërndarja e numrit të nxënësve dhe mungesave, sipas klasave

Trendi i numrit të nxënësve dhe i mungesave në mësim është i përafërt me komunitetet e tjera. Diferenca e numrit të nxënësve në hyrje-dalje në sistem është për 135 më i vogël (klasa I) në krahasim me klasën IX. Ndërsa numri i mungesave tregon rritje enorme nga kufiri i poshtëm (klasa I) në kufirin e epërm (klasa IX). Ky dallim është për 20094 mungesa. Nga gjithsej 118523 mungesa në nivel komune, rreth $\frac{1}{4}$ u takojnë nxënësve të klasës IX.



Grafiku 113


Përqindja e nxënësve dhe mungesave sipas klasave, në nivel komune

Rreth 9 mungesa kemi për kokë nxënësi, ndërsa në klasën IX rreth 18 mungesa për kokë nxënësi. Derisa 11% e nxënësve ishin në klasën IX, 22% e numrit të mungesave i kanë bërë ata.

Trendi i rënies së numrit të nxënësve edhe në këtë komunë është i dukshëm. Në bazë të të dhënave të SMIA-s për vitin shkollor 2018/2019, në krahasim me numrin e përgjithshëm të nxënësve të vitit paraprak, numri është për 543 nxënës më i vogël.

Mësimdhënësit


Nga gjithsej 943 mësimdhënës, sipas SMIA, kemi grumbulluar të dhëna për 876, ose rreth 92%.



Grafiku 114

Mësimdhënësit sipas përvojës, në nivel komune

Pasi që numri i mësimdhënësve (6-9) është më i madh, edhe diferenca është më e madhe në të gjitha nivelet e përvojës, me përjashtim të nivelit mbi 40 vjet.




Grafiku 115

Përvoja e mësimdhënësve e shprehur në përqindje – krahasimi

Dallime të mëdha në përqindje, sipas përvojës mësimdhënëse klasorë – mësimdhënëse lëndorë, shihet në nivelin 25-35, 24% me 12%. Te nivelet e tjera dallimi në përqindje është i parëndësishëm. Edhe mesatarja e mësimdhënësve të të dyja niveleve me përvojë mbi 15 vjet është e balancuar, rreth 40%, që i bie se rreth 60% e mësimdhënësve në shkollimin e detyrueshëm (1-9) janë me përvojë produktive.


Trajnimet



Grafiku 116

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e komunës

Shumica e mësimdhënësve të të dyja niveleve kanë 3 deri në 5 trajnime. Ndërsa që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim nuk kishte dallime në nivelet 6-9 dhe 1-5.




Grafiku 117

Shpërndarja në përqindje e trajnimeve të ndjekura nga të dyja palët, në nivel komune

Siç tregohet në grafik, dallimet në përqindje për numrin e trajnimeve të ndjekura nga të dyja grupet e mësimdhënësve janë shumë të përafërta. Dallimi më i theksuar shihet te niveli mbi 5 trajnime, një epërsi e mësimdhënësve klasorë, 21%, në krahasim me mësimdhënësit lëndorë, 14%. Ndërsa dallimi tjetër shihet te niveli 3 deri në 5 trajnime, ku prijnë mësimdhënësit lëndorë me 47%.

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës, si kryeqytet, ka përqendrimin më të madh të numrit të nxënësve dhe të mësimdhënësve. Sipas të dhënave të ASK/MASHT për vitin shkollor 2017/2018, gjithsej nxënës (1-9) ishin 30087, me të cilët punojnë 1679 mësimdhënës (m=381 dhe f=1298). Rreth 18 nxënës për një mësimdhënës.




Grafiku 118.

Nxënësit sipas klasave dhe mungesat në mësim, në nivel komune

Trendi i numrit të nxënësve dhe i mungesave në mësim është i ngjashëm me komunat e tjera. Për dallim nga shumica e komunave tjera, dallon numri i nxënësve në hyrje në sistem, më i lartë (klasa I), në krahasim me daljen (klasa IX), derisa në klasat tjera kemi luhatje, rënie-rritje. Ndërsa, trendi i

mungesave është i ngjashëm me komunat e tjera, nga klasa më e ulët vjen duke u rritur deri në shumëfishim në klasën e fundit, klasa IX. Diferenca midis kufirit të poshtëm, klasa I, me kufirin e epërm, klasa IX, është për 54352 mungesa. Derisa në klasë të parë për kokë nxënësi kemi rreth 3 mungesa, në klasën IX është mbi 19 mungesa për kokë nxënësi. Ndërsa në klasën V është mbi 5 mungesa për kokë nxënësi.

Siç shihet në grafik, ky trend vjen duke u rritur nga klasa në klasë për mijëra mungesa, me një dallim nga klasa III në klasën IV, ku numri i mungesave bie për 766 mungesa.




Grafiku 119

Përqindja e mungesave dhe e numrit të nxënësve sipas klasave, në nivel komune

Përqindja e numrit të nxënësve sipas klasave është thujse i balancuar, derisa përqindja e mungesave nga 4% në klasën e parë rritet në 24% në klasën e nëntë. Pas kalimit nga shkollimi fillor në shkollimin e mesëm të ulët, V-VI, numri i mungesave dyfishohet. Kjo dukuri vërehet në të gjitha komunat e Kosovës, por shkaqet ende nuk janë hulumtuar. Tani për tani vetëm mund të supozojmë.

Mësimdhënësit




Grafiku 120

Mësimdhënësit sipas përvojës, në nivel komune

Në përpunimin e të dhënave janë përfshirë gjithsej 1213 veta nga personeli mësimor, 93%, 765 mësimdhënës të nivelit 6-9 dhe 448 mësimdhënës 1-5, nga 1298 sa kishte sipas të dhënave të SMIA-s.

Sa i përket strukturës sipas përvojës kemi dallime në numër. Pasi që në numër mësimdhënësit janë më shumë, atëherë duhet të shohim se si është e shprehur kjo në përqindje.




Grafiku 121

Përqindja e mësimdhënësve klasorë dhe mësimdhënësve lëndorë, sipas përvojës

Bazuar në shpërndarjen sipas përqindjes, të dyja palët kanë përvojë 6-10 vjet, 30% e mësimitdhënësve 6-9 dhe 25% e mësimitdhënësve 1-5. Më shumë mësimitdhënës 6-9 sesa mësimitdhënës 1-5 janë edhe me përvojë midis 25-30 vjet, 20%, në krahasim me mësimitdhënësit, 12%. Më shumë mësimitdhënës klasorë janë me përvojë mbi 40 vjet në arsim, 4%, në krahasim me mësimitdhënësit lëndorë, 1%. Në nivelet e tjera nuk ka dallime të rëndësishme.


Trajnimet



Grafiku 122

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimitdhënësit, në nivel komune

Numri më i madh i mësimitdhënësve, në të dyja grupet, kanë mbi 5 trajnime, ndërsa më shumë ka mësimitdhënës klasorë sesa mësimitdhënës lëndorë që nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.



Grafiku 123


Përqindja e pjesëmarrjes në trajnime - krahasimi

Mbi 5 trajnime i kanë ndjekur 72% e mësimdhënësve 1-5, në krahasim me mësimdhënësit e nivelit 6-9, 55%. Por, 34% e mësimdhënësve 6-9 kanë ndjekur 3 deri në 5 trajnime, në krahasim me mësimdhënësit 1-5, 22%. Gjithashtu, mësimdhënësit lëndorë prijnë 10% në 1 deri në 2 trajnime, në krahasim me mësimdhënësit klasorë, 4%.

Niveli pa asnjë trajnim thuajse është i njëjtë me komunat e tjera, sillet 1-2%, herë për mësimdhënës klasorë dhe herë lëndorë.

Komuna e Prizrenit

Prizreni bën pjesë në komunat e mëdha, si për nga numri i shkollave ashtu edhe për nga numri i nxënësve. Radhitet si komuna e dytë, pas kryeqytetit. Sipas të dhënave të ASK/MAShT, në vitin shkollor 2017/2018 numri i nxënësve ishte 22194 në shkollimin e detyruar, me të cilët punojnë 1654 mësimdhënës (m=730 dhe F=924), ose rreth 13 nxënës për një mësimdhënës.




Grafiku 124

Numri i nxënësve dhe i mungesave sipas klasave, në nivel komune

Trendi i numrit të nxënësve dhe mungesave në mësim është i ngjashëm me trendët në komunat e tjera, të mesme dhe të mëdha. Kemi më shumë nxënës në dalje, për 127 nënës, sesa në hyrje në sistem.

Ndërsa, trendi i mungesave në mësim shumëfishohet nga kufiri i poshtëm, klasa I, në kufirin e epërm, klasa IX.




Grafiku 125

Përqindja e nxënësve për klasa dhe mungesat për klasë - krahasimi

Dallimi midis tyre është për 26093 mungesa. Derisa për kokë nxënësi në klasë të parë kemi mbi 2 mungesa, në klasën e IX kemi mbi 12 mungesa për nxënë. Në klasën e IX janë 12% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, por 25% e mungesave të bëra u takojnë nxënësve të kësaj klase. Mesatarja e nxënësve nëpër klasë/vite është e balancuar ngjashëm me komunat e mesme dhe të mëdha. Edhe trendi i mungesave është i ngjashëm në përqindje.


Mësimdhënësit



Grafiku 126

Mësimdhënësit sipas përvojës, në nivel komune

Pasi që nuk janë përfshirë 100% të mësimdhënësve në përpunim, vetëm (789) ose rreth 48%, të dhënat vlejnë për këtë mostër, jo për numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve të kësaj komune. Me përjashtim të nivelit të përvojës 11-15, ku dominojnë mësimdhënësit klasorë, në të tjerat nivele prijnë mësimdhënësit lëndorë.




Grafiku 127

Përqindja e mësimdhënësve sipas nivelit të përvojës në mësimdhënie

Siç tregohet në grafiku, mësimdhënës lëndorë më shumë në përqindje janë me përvojë 25-30- vjeçare (22%), në krahasim me mësimdhënësit klasorë (19%), ndërsa më shumë mësimdhënës klasorë kanë 6-10 vjet përvojë (20%), në krahasim me lëndorët (16%). Përqindjet tjera janë afërsisht të balancuara. Me rëndësi, gati në të gjitha komunat mësimdhënësit klasorë me mbi 40 vjet përvojë përbëjnë përqindje më të lartë sesa mësimdhënësit lëndorë.


Trajnimet



Grafiku 128

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit e të dyja grupeve

Për shkak të numrit më të madh, mësime lëndorë dominojnë pothuajse në të gjitha sasinë e trajnimeve. Më mirë kjo pasqyrohet në paraqitjen e pjesëmarrjes në përqindje.




Grafiku 129

Pjesëmarrja në trajnime shprehur në përqindje

Mësime lëndorë kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime (54%), në krahasim me mësime lëndorë (48%). Gjithashtu, me 1 deri në dy trajnime prijnë klasorët (16%), në krahasim me mësime lëndorë (11%). Por, mësime lëndorë kanë më shumë 3 deri në 5 trajnime (33%) në krahasim me mësime lëndorë (28%). Asnjë trajnim nuk e kanë ndjekur 8% e mësime lëndorëve në krahasim me mësime lëndorë klasorë, vetëm 2%. Edhe në këtë aspekt trendet në këtë komunë janë të përafërt me trendet në komunat e tjera sa u përket dallimeve në trajnime në raportin mësime lëndorë – mësime lëndorë klasorë.

Komuna e Shtimes


Komuna e Shtimes bën pjesë në komunat e reja, me numër shkollash dhe nxënësish në mesataren e komunave të vogla. Sipas të dhënave të ASK/MASHT (2018), kjo komunë kishte gjithsej 4129 nxënës në shkollimin e detyruar dhe 321 mësime lëndorë (m=168 dhe (f=153). Raporti nxënës – mësime lëndorë ishte rreth 13 nxënës për një mësime lëndorë. Afërsisht me mesataren e komunave të tjera në këtë raport.



Grafiku 130

Nxënësit dhe mungesat në nivel komune


Të dhënat nga shkollat e kësaj komune ndryshojnë pak nga komunat e tjera. Këtu nxënësit e klasës së parë kanë bërë më shumë mungesa në mësimet sesa ata të klasave II dhe III. Pastaj grafiku ka rritje-rënie, nga klasa VI në VII dhe vetëm rritje në klasat tjera. Derisa numri i mungesave për kokë nxënësi në klasën e parë është rreth 10, në klasën IX kjo është mbi 19 mungesa për kokë nxënësi. Diferenca midis kufirit të poshtëm, klasa I, dhe kufirit të epërm, klasa IX, është për 5938 mungesa.



Grafiku 131

Përqindja e mungesave në mësimet dhe numrit të nxënësve, sipas klasave


Dallimi midis hyrjes-daljes nga sistemi është për 100 nxënës më shumë në dalje, klasa IX, në krahasim me hyrjen, klasa I. Ky trend shihet në përqindjen e pjesëmarrjes së nxënësve nëpër klasa, nga 10% në klasën e parë, në 13% në klasën e nëntë. Ky trend është i ngjashëm me shumicën e komunave, ku lëvizja e nxënësve përgjatë shkollimit, nga klasa në klasë, pëson ndryshime, për të cilat nuk ka evidenca të qarta nëse ata e përsërisin klasën, e braktisin shkollimin ose migrojnë.



Grafiku 132

Mësimdhënësit sipas përvojës dhe nivelit


Në nivelin e përvojës deri në 5 dhe 6 deri në 10 vjet dominojnë mësimdhënësit lëndorë, por ka shumë më shumë mësimdhënës me përvojë mbi 40 vjet në nivelin 1-5. Pasi që mësimdhënës klasorë ka më pak, këtë e tregon shpërndarja sipas përqindjes së pjesëmarrjes në nivele të përvojës.



Grafiku 133


Shpërndarja e mësimdhënësve sipas përvojës - krahasimi

Shihen dy dallime më të theksuara sa i përket përqindjes së nivelit të përvojës. Mësimdhënësit lëndorë janë më shumë me përvojë 6-10 vjet, 23%, në krahasim me mësimdhënësit klasorë, 14%, ndërsa mësimdhënësit me përvojë mbi 40 vjet janë 18%, në krahasim me lëndorët, 3%. Po ashtu mësimdhënësit klasorë me deri në një vit përvojë janë më shumë, 13%, me 4%. Nivelet e tjera të përvojës kanë diferenca jo shumë të mëdha. Në vazhdim jepet numri i trajnimeve sipas viteve.



Grafiku 134

Mësimdhënësit sipas trajnimeve, në nivel komune




Grafiku 135

Përqindja e trajnimeve të mësimdhënësve në nivel komune - krahasimi

Pjesëmarrja në trajnime e të dyja palëve të mësimdhënësve është shumë e balancuar. Dallim më i theksuar shihet te niveli asnjë trajnim, ku 7% e mësimdhënësve 6-9 janë deklaruar dhe 1% e mësimdhënësve 1-5. Këso dallimesh kemi gati në të gjitha komunat.

Komuna e Skenderajt

Kjo komunë bën pjesë në mesin e komunave të mesme, me numër të nxënësve dhe të mësimdhënësve. Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), kishte gjithsej 7347 nxënës me të cilët punojnë 513 mësimdhënës (m=310 & f=203). Numri i nxënësve për një mësimdhënës është rreth 14.



Grafiku 136

Numri i nxënësve sipas klasave, në nivel komune

Të dhënat për këtë komunë janë raportuar nga DKA-ja, kështu që nuk u përfshinë të dhënat për mungesat e nxënësve në mësim. Kemi disa specifika të numrit të nxënësve të raportuara nga ASK/MAShT, pasi numri i nxënësve për klasa ka rënie-ngritje. Për këtë bëmë një analizë krahasuese të viteve 2017/2018 me 2018/2019.

Tabela 10


Kalimi i nxënësve nga klasë paraprake në klasën vijuese, në nivel komune

2017/2018	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Nxënës	801	797	774	795	758	842	813	878
2018/2019	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Nxënës	774	781	757	780	758	819	784	852
Diferenca	- 27	- 16	- 17	- 15	00	- 23	- 29	- 26

Tabela paraqet kalimin e nxënësve nga klasa paraprake në klasën vijuese. Vetëm kalimi nga klasa V në klasën VI është 100%. Nuk ka të dhëna nëse këta nxënës janë përsëritës, kanë kaluar në shkolla të tjera, ose e kanë ndërprerë shkollimin.

Nga klasa e parë deri në klasën e nëntë në sistem mungojnë 153 nxënës. Pastaj në vitin mësimor 2018/2019 janë regjistruar 132 nxënës më pak në klasën e parë (757, në krahasim me një vit më parë, kur ishin regjistruar 801, dhe 88 më shumë e kanë përfunduar klasën IX. Kështu, brenda kësaj periudhe kemi 285 nxënës më pak (7347-7062=285).


Mësimdhënësit



Grafiku 137

Struktura e mësimdhënësve sipas përvojës në mësimdhënie


Nivelit të përvojës 25-30 dhe 30-34 i takojnë më shumë mësimdhënës të nivelit 6-9 sesa mësimdhënës 1-5. Nivelet tjera thuajse janë të balancuara. Kjo më mirë duket te shpërndarja sipas përqindjes.



Grafiku 138

Niveli i mësimdhënësve sipas përvojës, shprehur në përqindje – krahasimi


Përqindja më e theksuar e mësimdhënësve bëjnë pjesë në tri nivele të përvojës, si: 25-30 rreth 26%, pastaj 30-35 rreth 20%, si dhe deri në 5 vjet 15% prej tyre. Ndërsa te mësimdhënësit deri 5 vjet 21%, pastaj 30-35 rreth 20%, si dhe nga 16% në dy nivele. Nivelet tjera janë të përafërta.



Grafiku 139

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit, në nivel komune

Shumica e mësimeve kanë ndjekur më shumë se 5 trajnime, ose rreth 66%, pastaj 3 deri në pesë. Ndërsa asnjë trajnim nuk e kanë ndjekur më shumë mësimeve lëndorë. Pasqyrim më i mirë do të shihet në paraqitjen e pjesëmarrjes në trajnime, shprehur në përqindje, pasi që dallimi në numër mësimeve lëndorë – mësimeve klasorë është i dukshëm.




Grafiku 140

Përqindja e pjesëmarrjes në numrin e trajnimeve - krahasimi

Të dyja grupet kanë më së shumti mbi pesë trajnime të ndjekura. Në përqindje simbolike prijnë mësimeve e nivelit 6-9 në këtë aspekt, ndërsa mësimeve e nivelit 1-5 kanë përqindje më të lartë, në 3 deri në pesë trajnime. Trendi është thuajse i ngjashëm me komunat e tjera në këtë aspekt.

Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës bën pjesë në komunat mesatare për numrin e nxënësve dhe të mësimeve. Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), kjo komunë kishte gjithsej 8294 nxënës në shkollimin e detyruar (1-9), me të cilët punojnë gjithsej 648 mësimeve (m=309, f=339 ose rreth 52%). Raporti nxënës-mësimeve në këtë komunë ishte rreth 13 nxënës për mësimeve.




Grafiku 141

Numri i nxënësve dhe i mungesave në mësim, sipas klasave

Edhe këtu shihet thujtjse i njëjti trend i numrit të nxënësve dhe mungesave. Në ciklin fillor kemi një ngritje-rënie të numrit të mungesave, ndërsa në ciklin e mesëm të ulët vetëm rritje. Dallimi midis nivelit të ulët me atë më të lartit, klasa IX, është për 5787 mungesa. Numri i mungesave për kokë nxënësi ishte rreth 6 mungesa. Është një mesatare e ulët në krahasim me disa komuna të tjera. Por, kjo për kokë nxënësi të klasës IX ishte mbi 9 mungesa për nxënës.

Sa i përket numrit të nxënësve, diferenca nga faza e hyrjes, klasa I, dhe daljes nga sistemi, klasa IX, është për 25 nxënës më shumë në dalje. Nuk është dallim i madh në krahasim me disa komuna të tjera.



Grafiku 142


Përqindja e nxënësve dhe e mungesave të nxënësve sipas klasave, në nivel komune

Diferenca midis numrit të nxënësve për klasa, si dhe shpërndarjes së numrit të mungesave për klasë nuk është shumë e madhe, sikurse në disa komuna të tjera. Numri i nxënësve është tejet i balancuar, ndërsa diferenca e mungesave nga niveli më i ulët tek niveli më i lartë është e dukshme. Klasës së parë i takojnë 7% e mungesave, derisa klasës së nëntë 19%. Rreth 70% e mungesave në mësim janë bërë nga nxënësit e shkollës së mesme të ulët, ndërsa në ciklin fillor kemi një luhatje ngritje-rënie në klasat 2-4, rënie në klasën e pestë, pastaj vetëm ngritje, deri në fund të ciklit të shkollimit të detyrueshëm (IX).

Trendi i rënies së numrit të nxënësve, por edhe i rritjes së numrit të mungesave, nga klasa në klasë, është më normal, pa ndryshime të mëdha, sikurse në disa komuna tjera të Republikës.

Mësimdhënësit

Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve që punojnë në shkollimin e detyrueshëm është 648.




Grafiku 143

Struktura e mësimdhënësve të të dyja niveleve, sipas përvojës së punës

Vetëm në dy ekstremet e përvojës prijnë mësimdhënësit deri në 1 vit si dhe mbi 40 vjet. Në të tjerat dominojnë mësimdhënësit (6-9). Por pjesëmarrja në


shpërndarjen sipas përvojës, për shkak të numrit më të madh të mësimdhënësve, shihet sipas përqindjes së shpërndarjes.



Grafiku 144

Përqindja e mësimdhënësve sipas përvojës - krahasimi


Shpërndarja e mësimdhënësve sipas përqindjes së përvojës te mësimdhënësit është shumë e balancuar. Mësimdhënësit kanë shpërndarje me dallime të rëndësishme. Dominojnë ata me përvojë 25-30 vjet te lëndorët me 24%, pastaj në vend të dytë janë dy grupe, 6-10 dhe 16-20 vjet. Mësimdhënës të rinj, deri në një vit, te klasorët janë 10% në krahasim me lëndorët, 2%. Po ashtu, 7% e mësimdhënësve klasorë kanë mbi 40 vjet përvojë, në krahasim me mësimdhënësit lëndorë, asnjë.



Grafiku 145

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësimdhënësit, në nivel komune

Sikurse në komunat e tjera, edhe këtu shumica e mësimitdhënësve kanë 3 deri në 5 dhe mbi pesë trajnime. Asnjë trajnim nuk e kanë gjithsej 53 mësimitdhënës. Kjo shpërndarje pasqyrohet më mirë në përqindje.




Grafiku 146

Përqindja e numrit të trajnimeve, në të cilat kanë marrë pjesë mësimitdhënësit

Prijnë mësimitdhënësit klasorë me mbi 5 trajnime, 32%, dhe 1 deri 2 trajnime 28%. Ndërsa mësimitdhënësit lëndorë rijnë me 3 deri 5 trajnime me 39%, në krahasim me mësimitdhënësit, 31%. Me asnjë trajnim janë të barabartë, me 9%, të cilët nuk kanë ndjekur asnjë trajnim.

Komuna e Vitisë


Kjo komunë bën pjesë në komunat nën mesataren për nga numri i nxënësve dhe mësimitdhënësve. Sipas të dhënave të ASK/MAShT (2018), Vitia kishte 6106 nxënës në shkollim të detyruar (1-9) dhe 537 mësimitdhënës (m=271, afro 50.5% dhe f=266 ose 49.5%), për dallim nga shumica e komunave, ku dominon gjinia femërore e mësimitdhënësve. Raporti mësimitdhënës – nxënës është mbi 11 nxënës për një mësimitdhënës.



Grafiku 147

Numri i nxënësve dhe i mungesave sipas klasave, në nivel komune

Afërsisht sikurse në komunat e tjera, numri i nxënësve në hyrje në sistem është më i vogël në krahasim me daljen nga sistemi, klasa IX. Diferenca është për 145 nxënës më pak.




Grafiku 148

Përqindja e mungesave dhe e nxënësve sipas klasave - krahasimi

Klasa IX përbën 13% të numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e detyrueshëm në nivel komunal, por ka 30% të mungesave të bëra nga shuma e përgjithshme. Trandi i numrit të nxënësve dhe mungesave edhe në këtë komunë është i ngjashëm.


Mësimdhënësit



Grafiku 149

Mësimdhënësit sipas përvojës

Numri më i madh i mësimdhënësve klasorë janë në nivelin e përvojës 6-10, pastaj 16-20, dhe në vendin e tretë deri në 5 vjet janë lëndorët. Pasi që mësimdhënësit lëndorë janë më shumë sesa mësimdhënësit klasorë në shumicën e niveleve prijnë, me përjashtim të nivelit 11-15 dhe 6-10.




Grafiku 150

Përqindja e mësimdhënësve sipas përvojës - krahasimi

Mësimdhënës të nivelit 6-9 më shumë janë të përvojës deri në 5 vjet (19%), ndërsa mësimdhënësit e nivelit 1-5 vetëm 8%, por më shumë i përkasin përvojës 6-10, me 22%.

Me përvojë 16-20 vjet përqindja është e njëjtë (16%). Nivelet tjera janë të përafërta.


Trajnimet



Grafiku 151

Trajnimet e ndjekura nga mësimdhënësit, në nivel komune

Shumica e mësimdhënëseve kanë ndjekur 3-5 trajnime, pastaj 1-2 trajnime, dhe në vendin e tretë janë mësimdhënësit me mbi 5 trajnime. Në këtë grup prijnë mësimdhënësit e nivelit 1-5, në krahasim me mësimdhënësit e nivelit 6-9. Në dy grupet tjera prijnë mësimdhënësit e nivelit 6-9, me përjashtim të grupit asnjë trajnim të përfunduar.



Grafiku 152


Përqindja e pjesëmarrjes në trajnime – krahasimi

Mësimdhënësit e nivelit 6-9 kanë ndjekur më shumë 1 deri 2 trajnime, (43%), në krahasim me mësimdhënësit e nivelit 1-5, (24%). Kurse

mësimdhënësit e nivelit 1-5 prijnë me 3 deri 5 trajnime, me 46%, në krahasim mësimdhënësit 6-9, 39%. Gjithashtu, mësimdhënësit klasorë prijnë me 28% më shumë se 5 trajnime, në krahasim me lëndorët, me 13%. Në komunat tjera dominojnë mësimdhënësit e nivelit 6-9 me më shumë trajnime të ndjekura.

Komuna e Vushtrisë

Sipas të dhënave të vitit 2018, Vushtrria kishte gjithsej 10126 nxënës, e cila bën pjesë në komunat mesatare. Numri i mësimdhënësve ishte 589 (m=269 dhe f=320). Mesatarja e nxënësve për një mësimdhënës ishte mbi 17 nxënës për një mësimdhënës, që është mbi mesataren e komunave tjera në Republikën e Kosovës.




Grafiku 153

Numri i nxënësve dhe mungesat sipas klasave, në nivel komune

Pothuajse trendi i lëvizjes së numrit të nxënësve dhe mungesave në mësimet është i njëjtë, sikurse në komunat e tjera. Nxënësit e kësaj komune gjithsej brenda një viti kanë bërë 104244 mungesa. Nga klasa më e ulët trendi shkon duke u rritur deri në klasën IV, por shihet një rënie e madhe në klasën V, për t'u rritur shumë në klasat tjera. Diferenca mes kufirit të poshtëm dhe kufirit

të epërm të numrit të nxënësve është për 131 nxënës më pak. Ndërsa diferenca e numrit të mungesave midis dy kufijve është për 23608 mungesa. Sikurse në komunat tjera, numrin më të madh të mungesave në mësimet e kanë nxënësit e klasës IX. Për kokë nxënësi të kësaj klase iu bie rreth 23 mungesa, ndërsa në nivel komune për kokë nxënësi mbi 10 mungesa. Shihet diferencë e lartë e numrit të mungesave midis klasave V dhe VI, ku numri gati dyfishohet. Derisa në klasën V janë 6605 mungesa, në klasën VI janë 13110, ose për 6505 mungesa më shumë. Kjo dukuri është me interes të hulumtohet.

Shpërndarja e numrit të nxënësve për klasa dhe numrit të mungesave më mirë shfaqet në shpërndarjen e tyre sipas përqindjes.




Grafiku 154

Numri i nxënësve dhe i mungesave sipas klasave, shprehur në përqindje

Pjesëmarrja e nxënësve, sipas përqindjes, është shumë e balancuar, me ngritje-rënie të vogla. Numri i mungesave shënon ngritje nga niveli më i ulët, klasa I, deri në nivelin më të lartë, klasa IX, ky numër shumëfishohet.


Mësimdhënësit



Grafiku 155

Mësimdhënësit sipas nivelit të përvojës, në nivel komune


Siç tregohet në grafikun 155, niveli i përvojës 6-10 dominohet nga mësimdhënësit e nivelit 6-9, pastaj në vendin e dytë janë mësimdhënësit me përvojë deri në pesë vjet. Në vendin e tretë janë mësimdhënësit me përvojë 16-20 vjet. Të dyja palët kanë numër afërsisht të afërt të përvojës, mbi 40 vjet. Si i përket përqindjes së shpërndarjes së mësimdhënëseve sipas përvojës, ka një diferencë ndërmjet mësimdhënëseve lëndorë dhe mësimdhënëseve klasorë.



Grafiku 156

Përqindja e mësimdhënëseve sipas përvojës, në nivel komunal


Dallime më të larta janë në moshën 25-30 vjet, ku përfshihen 18% e mësimeve të mësimdhënësve të nivelit të lartë dhe 8% e mësimeve të klasorëve, kurse të 36-40 mësimeve të klasorëve bëjnë pjesë me 9%, në krahasim me mësimeve të nivelit të lartë, 3%. Nivelet tjera të përvijës janë të përafërta.



Grafiku 157

Pjesëmarrja e mësimeve të nivelit të lartë në trajnime

Numri më i madh i mësimeve të nivelit të lartë kanë ndjekur 3-5 trajnime. Në vendin e dytë janë mësimeve të klasorëve me mbi 5 trajnime dhe në vendin e tretë ata me 1-2 trajnime. Me asnjë trajnim të kryer janë thuhet të barabartë.



Grafiku 158

Përfaqësimi i pjesëmarrjes në trajnime - krahasimi

Me mbi pesë trajnime dominojnë mësimdhënësit e nivelit 1-5, me 44%, në krahasim me mësimdhënësit e nivelit 6-9, 23%, por mësimdhënësit e nivelit 6-9 dukshëm dominojnë në nivelin 3 deri 5 trajnime, me 45%, në krahasim me mësimdhënësit tjerë, 28%. Gjithashtu, në nivelin 1 deri në 2 trajnime janë 28% e mësimdhënësve lëndorë, në krahasim me mësimdhënësit klasorë, 22%. Të dyja grupet kanë afërsisht përqindje të mësimdhënësve pa asnjë trajnim të ndjekur.

PËRFUNDIME

Hulumtimi është mjaft sfidues për të gjithë faktorët e përfshirë, pasi që shtrihet në shkallë vendi dhe përmasat e problemit janë mjaft të gjera dhe komplekse.

Ndikimi i projektit në zgjidhjen e problemit mund të jetë i lartë, ngase të dhënat e dala nga hulumtimi pritet të ndikojnë në zvogëlimin e përmasës së problemit. Mbi bazën e këtyre të dhënave, do të ndërmerren hapat për ndërhyrje, me qëllim të përmirësimit të gjendjes.

Nga analizat e bëra treguesve të përzgjedhur, si: lëvizja e numrit të nxënësve në nivel vendi dhe sipas komunave; ndryshimet e rëndësishme të identifikuar gjatë analizës; numri i mungesave dhe specifikat sipas klasave, komunave dhe në nivel vendi; numri i trajnimeve të mësimdhënësve dhe mësimdhënësve, flasin mjaftueshëm për gjendjen e arsimit në vend.

Statistikat që i prodhojnë ASK-ja dhe SMIA, në kuadër të MASHt-it, janë të mjaftueshme vetëm në nivel të raportit të numrave, por jo edhe të analizës së tyre. Pa një analizë të thelluar të treguesve, të shprehur vetëm në numra, nuk mund të gjykojmë për gjendjen e arsimit dhe për kahet e zhvillimit të arsimit në vend, por edhe për vetë sistemin e arsimit.

Analiza e bërë, vetëm për treguesit e përfshirë: lëvizja e numrit të nxënësve, mungesat në mësim, struktura e mësimdhënësve sipas përvojës, pra edhe e moshës, sasia e trajnimeve të ndjekura, nuk mjaftojnë për të gjykuar gjendjen e sistemit arsimor, por vetëm për këto aspekte të shqyrtuara. Aspektet e shqyrtuara janë tregues të rëndësishëm për vendimmarrësit, DKA-të, shkollat dhe mësimdhënësit për të bërë analiza më të thelluara, të cilat do t'u shërbejnë për planifikime dhe për ndryshime të caktuara.

Disa nga përfundimet e rëndësishme të identifikuar gjatë analizës janë si në vijim:

Vazhdon të bjerë numri i nxënësve në shumicën e komunave në nivel të Republikës. Me pak përjashtime, numri i nxënësve që hyjnë në sistem, klasa I, është më i vogël, në krahasim me numrin e atyre që dalin nga sistemi, klasa IX.


Gjatë kalimit nga një klasë në tjetrën, në shumicën e rasteve, numri i nxënësve bie dhe nuk ka shënime të sakta se çfarë ndodh me ta: e braktisin shkollimin, emigrojnë apo e përsërisin klasën. Kjo vërehet në të gjitha komunat dhe në të gjitha shkollat. Edhe pse bie numri i nxënësve, numri i mësimdhënësve ose është i njëjtë, ose është rritur.

Raporti mësimdhënës-nxënës nga komuna në komunë ndryshon shumë. Në disa komuna ky raport është nën 10 nxënës për një mësimdhënës, ndërsa mesatarja sillet rreth 14 nxënës për një mësimdhënës.

Brenda një viti shkollor, nxënësit e shkollave të përfshira në këtë analizë kanë bërë mbi 1 milion e 600 mijë mungesa. Numri më i madh i mungesave në mësim është bërë nga nxënësit e klasës IX. Grafiku i mungesave nga klasa I deri IX vjen duke u rritur deri në shumëfishim. Numri i mungesave për klasa dhe për kokë nxënësi dallon nga komuna në komunë dhe nga shkolla në shkollë. Nuk ka të dhëna relevante për arsyen e mungesave në mësim në një shifër kaq të lartë. Mungesat nuk raportohen nga ASK-ja dhe as nga SMIA.

Përvoja e mësimdhënësve ndryshon nga komuna në komunë. Ka një laramani midis dy grupeve të mësimdhënësve, sipas nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, sa i përket përvojës në mësimdhënie. Këtë e tregojnë grafikët e dhënë më lart, si në nivel vendi, po ashtu edhe në nivel komune.


Mësimdhënësit kanë ndjekur numër të caktuar të trajnimeve. Shumica syresh kanë ndjekur mbi pesë trajnime dhe deri në pesë trajnime. Është tejet i vogël numri i atyre që nuk kanë asnjë trajnim të kryer. Dallimet midis mësimdhënësve klasorë dhe mësimdhënësve lëndorë, sa i përket numrit të trajnimeve, janë të vogla në nivel vendi. Ka disa dallime të rëndësishme në disa komuna.



Grafiku 159

Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësuesit – krahasimi në nivel vendi


Siç tregon grafiku, 48% e mësuesve klasorë kanë ndjekur më shumë se 5 trajnime, në krahasim me mësuesit lëndorë, 39%, që kanë ndjekur më shumë se pesë trajnime. Mësuesit klasorë 3 deri në 5 trajnime kanë ndjekur 32%, në krahasim me mësuesit lëndorë, 36%. Gjithashtu, mësuesit lëndorë ka më shumë që kanë ndjekur 1 deri 2 trajnime, 20%, në krahasim me mësuesit klasorë, 17%. Asnjë trajnim nuk e kanë ndjekur 5% e mësuesve të nivelit 6-9 dhe 3% e mësuesve 1-5.



Grafiku 160

Numri i mungesave sipas klasave, në nivel vendi

Grafiku tregon trendin e rritjes së mungesave nga klasa në klasë. Diferenca midis kufirit të poshtëm (klasa I) me kufirin e sipërm (klasa IX) është shumë e lartë, për 294666 mungesa. 23% e numrit të përgjithshëm të mungesave janë bërë nga nxënësit e klasave të nënta.



Grafiku 161

Shtirja e numrit të mungesave sipas komunave të përfshira në analizë

Nga numri i përgjithshëm i mungesave (1.648,190) të raportuara nga shkollat e përfshira, 16% u takojnë nxënësve të Komunës së Prishtinës, pasi që edhe kanë numër më të madh të nxënësve. Edhe pse komuna e Prizrenit për nga numri i nxënësve është e dyta, ka numër të njëjtë të mungesave me komunën e Lipjanit, 8%. Një shembull për ilustrim për trajnimet po japim në tabelën në vijim.

Tabela 11

Mësimdhënësit e nivelit 6-9 dhe mësimdhënësit e nivelit 1-5, sipas shkallës së përvojës, në nivel vendi

Përvoja	Deri 1vj	Deri 5vj	6-10	11-15	16--20	25-30	30--35	36-40	Mbi 40
Mësimdhënësit	1043	785	707	670	658	662	720	738	6063
%	5	15	17	10	14	18	13	6	2
Mësimdhënësit	2091	1585	1431	1350	1330	1342	1453	1482	12128
%	6	11	17	13	13	14	9	12	5

Siç shihet në tabelë, nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë në mostër, numri më i madh i përket përvojës 25-30 vjet, sipas Huberman (1998) të ‘distancës racionale e qetësisë’, 18%, dhe 14% e mësimdhënësve. Ndërsa përqindja më e lartë e mësimdhënësve (17) i përket përvojës 11 deri në 15 vjet. Me përvojë mbi 40 vjet janë 5% e mësimdhënësve, në krahasim me 2% të mësimdhënësve të nivelit tjetër.

REKOMANDIME

Nga të dhënat e trajtuara në këtë analizë, mund të adresohen rekomandime për nivelin qendror vendimmarrës, nivelin komunal - DKA dhe në nivel shkolle. Rekomandimet nuk kanë qëllim më vete, por duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje, me qëllim ndryshimi dhe përmirësimi të gjendjes bazuar në të dhëna.

Për Ministrinë e Arsimit rekomandimet janë në nivel të hartimit të politikave bazuar në të dhëna, por edhe për domosdonë e prodhimit të të dhënave dhe analizës së tyre, për qëllime të arsytimit të vendimeve dhe të politikave:

Të shtohet përgjegjësia e raportimit të të dhënave nga shkollat dhe DKA-të, duke bërë kontrole të vazhdueshme të tyre, me qëllim verifikimin e saktësisë së të dhënave;

Në kuadër të SMIA-s, të caktohet një analist statistikor, i cili, përveç tjerash, do të trajtonte edhe treguesit e përfshirë në këtë analizë, si dhe suksesin e nxënësve;

Bazuar në të dhënat, analizat e treguesve statistikorë, të hartohen politikat për planifikim të kuadrove arsimore, si dhe të rrjetit shkollor;

Të dhënat për lëvizjen e nxënësve të bëhen në bazë të gjendjes reale të tyre në terren, duke bërë specifikimin e çdo lëvizjeje, qoftë migrim, emigrim, braktisje shkollimi, apo ndonjë specifikë tjetër.

Të vendoset rregull në format e zhvillimit profesional të mësimdhënësve bazuar në nevojat e tyre dhe jo në bazë të ofertave.

Rekomandime për DKA-të

Të dhënat statistikore të përpunohen edhe në kuadër të DKA-së, si dhe të analizohen, duke nxjerrë orientime të qarta për gjendjen në arsim në nivel komune (shumica e DKA-ve nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë të gjitha të dhënat e kërkuara, për shkak të mungesës së tyre, ose të mungesës së kuadrit për përpunimin e këtyre të dhënave);

Të dhënat e grumbulluara nga shkollat, përveç përpunimit dhe analizës, të verifikohen edhe për saktësinë e tyre;

Për mungesë të saktësisë së të dhënave, të zbatohet UA për përgjegjësitë e shkollës për grumbullimin dhe raportimin e të dhënave të sakta;

Hartimi i Planit Zhvillimor për arsim në nivel komunal të bëhet duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga shkollat, analizën e tyre;

Të mblidhen dhe të raportohen të dhënat e hollësishme për nxënës dhe mësimdhënës: sukses, mungesa, përvojë, trajnime, mjete mësimore etj., si tregues të rëndësishëm për përfshirje në planifikim.

Rekomandime për shkollat

Të mbajnë dhe të raportojnë të dhëna të sakta për të gjithë treguesit e shkollës, duke përfshirë edhe të dhënat për përvojën dhe trajnimet e mësimdhënësve;

Të mbajnë shënime të sakta për mungesat e nxënësve në mësim, si dhe të bëjnë analizën e vazhdueshme të tyre, për llojin e mungesave, kohën kur janë bërë, orët e humbura, sidomos për shkaqet e numrit të madh të mungesave në mësim nga nxënësit e klasës IX, por edhe të klasave të tjera;

Të marrin vendime të caktuara për përmirësimin e kushteve të punës, por edhe të shkaqeve të mungesave në mësim;

Nga shkaqet e identifikuar për mungesat në mësim, të marrin veprime të caktuara për përmirësimin e gjendjes, ose avancimin e dimensioneve të caktuara të ngecjes;

Raporti nga të dhënat të bëhet pjesë përbërëse e swot analizës, si dhe pjesë e planit të veprimit për aspekte të caktuara, siç janë: plani i regjistrimit të nxënësve, organizimi i brendshëm i shkollës, organizimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve bazuar në problemet e identifikuar, siç janë suksesi për lëndë, rezultatet nga vlerësimi i jashtëm, numri dhe lloji i mungesave, si dhe identifikimi i shkaqeve;

Të respektohet UA për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, qoftë në DKA ose në SMIA, duke ngritur nivelin e përgjegjësisë për saktësi në raportim.

Të fuqizohen ekipet për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM) dhe të punohet më tepër me nxënësit që bëjnë shumë mungesa.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna më lart është detyrim ligjor për institucionet dhe individët e përmendur. Duke zbatuar ato ndikojmë në përmirësimin e gjendjes në arsim, ndërsa treguesve të analizuar u japim kahe pozitive. Të dhënat janë resurse me rëndësi të veçantë shtetërore, prandaj edhe duhet konsideruar si të tilla.

Post scriptum

Në këtë analizë statistikore të treguesve të gjendjes janë përfshirë gjithsej shkollat e 23 komunave. Pse nuk janë përfshirë të gjitha shkollat dhe të gjitha komunat në këtë analizë? E para, nuk arritëm që t'i mbledhim të dhënat as nga DKA-të dhe as nga të gjitha shkollat. Disa nuk ofruan të gjitha të dhënat e kërkuara, prandaj të dhënat gjysmake nuk i kemi përfshirë në analizë. E dyta, disa komuna të vogla nuk i kemi përfshirë pasi që, për shkak të numrit tejet të vogël të nxënësve dhe të mësimdhënësve, të dhënat nuk tregonin shumë për kahet e zhvillimit të treguesve arsimorë në nivel Republike.

Të dhënat për numrin e nxënësve, kahet e lëvizjes, mungesat e nxënësve, mësimdhënësit sipas përvojës, dhe numrit të trajnimeve të ndjekura sipas komunave, tregojnë se sa të rëndësishme janë të dhënat për të marrë vendime adekuate për përmirësimin ose avancimin e sistemit arsimor, ose të segmenteve të tij.

Çfarë mbetet për të hulumtuar në të ardhmen? A mund të ketë lidhje ndërmjet këtyre treguesve dhe rezultatit të nxënësve në vlerësimin e jashtëm, siç janë Testi i arritshmërisë, PISA etj.?

REFERENCAT

1. ASK/MASHT (2019). Statistikat e Arsimit në Kosovë, SMIA, 2018-2019.
2. ASK/MASHT (2018). Statistikat e Arsimit në Kosovë, SMIA, 2017-2018.
3. Qendra për Arsim e Kosovës (2002). *Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës*. Prishtinë.
4. Devetaku-G. H., Mehmeti, S. (2014). “Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
5. Potera, I. (2012 Rëndësia e të Dhënave Statistike për Vendimmarrje në Arsim (Analizë e gjendjes në Kosovë). Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-068 (2008).
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 (2011).
8. Morina, B. & Mekolli, S. (2016). Mungesat e nxënësve në procesin mësimor në shkollat e mesme të larta në Kosovë. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
9. MASHT (2016). Udhëzimi Administrativ për SMIA
10. Majkëll, F. (2010). Forcat e Ndryshimit, Depërtimi në thellësitë e reformës arsimore dhe vazhdimi, CDE, Tiranë.
11. MASHT. (2010). Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë, 2011-2016.
12. MASHT. (2011). Katalogu i programeve të akredituara për zhvillim profesional të mësimit dhe të udhëheqësve të arsimit, Prishtinë.

13. Buleshkaj, O. & Mehmeti, S. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të drejtorëve të shkollave për ngritje të kapaciteteve në udhëheqje arsimore, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.
14. *EU (2010). Teachers' Professional Development Europe in international comparison - An analysis of teachers' professional development based on the OECD's Teaching and Learning International Survey (TALIS).*
15. Karameta, P. (2010). Analiza e produkteve të reformës arsimore, arritjet dhe sfidat për përmirësimin e shkollës, f. 13 (version elektronik i shkarkuar më 01.03.2011).
16. Koliqi, H. (2004). Sistemi i Arsimit në Kosovë, Libri Shkollor, Prishtinë.
17. Saqipi, B. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të mësimdhënësve, zhvillimi profesional për zbatimin e Kornizës së re të kurrikulumit të Kosovës, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.
18. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (2010), Autonomia Financiare e Shkollës – Delegimi i buxhetit dhe i financave në nivel shkolle.
19. Morina, B. (2017), Realizimi i Planit Zhvillimor të Shkollës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, në disa komuna, Kërkime Pedagogjike, Prishtinë.
20. Reforma e sistemit arsimor parauniversitar, Tiranë, maj 2014.
21. Higher Education in Kosovo: Major Changes, Reforms and Development Trends at University of Prishtina and University of Mitrovica and their role in peace building and reconciliation during post-conflict period Armend Tahirsylaj, M.Ed, <http://www.erisee.org/downloads/2013/2/Higher%20Education%20in%20Kosovo-%20Major%20Changes%202008%20ENG.pdf>
22. Situational analysis of education in kosovo, UNICEF Kosovo January 2004. Http://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo_media_publication.006.04.pdf

23. Brief situation analysis of the education sector in Kosovo, June 2014 Prishtinë, Kosovë
24. Kosovo accreditation agency (kaa), self-evaluation report „Approved by KAA’s Board on 24 October 2013, This Report is also available on-line on the Agency’s website, <http://www.akreditimi-ks.org>,
25. Promoting economic development through civil society, phase ii (2002-2004) education and economic development of Kosova (Research report - Draft) February 2004
26. Twinning project 2014 – 2016 on the development of pre-university education in Kosovo: Support Implementation of the Kosovo Education Sector Strategic Plan 2011-2016, KS 11 IBOT 02.
27. Zuna, A. Deva & bashkëpunëtorët (2009). Partneriteti shkollë-familje-komunitet, sfidë vijanoze”, Prishtinë.

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi
Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

Tirazhi: 300 copë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373(496.51)

Gjendja dhe zhvillimet aktuale që ndikojnë në cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë : (arsimin e obligueshëm, nivelet I dhe II) / Ismet Potera...[et al]. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2019.- 145 f. : ilstr. ; 24 cm.

1. Potera, Ismet 2. Shala, Luljeta 3. Morina, Bekim
4. Shala Safete

ISBN 978-9951-591-48-5

ISBN 978-9951-591-48-5



9 789951 591485